



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË SË
AMBIENTIT – BSc.

(2019 – 2022)

1. Një vështrim i shkurtër i programit në vlerësim: INXHINIERI E AMBIENTIT (BScIA)

Në kuadër të pesë Departamenteve të mbuluara nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, përfshihet edhe Departamenti i Inxhinierisë së Ambientit me program të studimit të nivelit bachelor Inxhinieri e Ambientit (tutje si BScIA). Politikat dhe procedurat e hartuara dhe të miratuara për të gjitha programet, nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës janë të zbatueshme edhe për programin e studimit BScIA. Personeli mësimor i angazhuar në programin e studimit BScIA është i kualifikuar dhe me përvojë si në mësimdhënie ashtu edhe në fushën e vecantë për të cilën janë të angazhuar. Si të tillë, mësimdhënësit kontribuojnë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në përgjithësi, e në vecanti në nxitje të motivimit, e reflektimit në procesin mësimor.

Hapja e programit të studimit BScIA, bazohet në arsyeshmëritë në vijim:

Sipas Programit Kombëtar të Shkencës, i cili ka identifikuar pesë prioritetet kombëtare shkencore me qëllim që të krijohen kushte edhe për përgatitje të një programi sistematik arsimor hulumtues, “Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi” zë vendin e parë në mesin e këtyre pesë prioritetëve. Kjo për arsye se, vendi është duke u përballur me shfrytëzim të pakontrolluar të burimeve natyrore, dendësi të madhe të popullatës dhe prani të aktiviteteve ekonomike me ndikim të madh në ambient. Si rezultat i kësaj, dhe sidomos qasja e shfrytëzimit jo fer të ambientit në vendin tonë (përballja e ndërveprimit midis aktiviteteve njerëzore dhe ndikimi i tyre në burime natyrore, ndryshime klimatike etj.) kanë bërë që në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të ofrohet programi i ri i studimit të nivelit bachelor, Inxhinieri e Ambientit. Ky program është i pari dhe i vetmi i kësaj lëmie në Institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë, andaj dhe luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore që do të kontribuojnë në përmirësimin e ambientit.

Qëndrueshmëria e ambientit arrihet kur integrohen principet shkencore me teknologjinë për të përmirësuar ambientin, ashtu që të ofrohet ujë, ajër dhe tokë e shëndetshme si komponente jo të gjalla të ekosistemit për qeniet e gjalla si komunitet i ekosistemit. Duke qenë se Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës ka një rol të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve intelektuale në fushën e ndërtimit, si dhe duke marrë parasysh nevojën për ambient të shëndetshëm për shoqërinë, përmes këtij programi, institucioni ynë ofron potencial për bashkëpunim interdisiplinar, dhe është në harmoni me nevojat aktuale të shoqërisë për ambient të shëndetshëm. Inxhinieria e së ardhmes, tash, më shumë se kurrë ka potencial për të pasur ndikim të madh në ambient. Prandaj, është më se e nevojshme që inxhinierët të menaxhojnë në mënyrë inteligjente edhe burimet natyrore të shfrytëzuara për zhvillim e edhe mbetjet e gjeneruara nga ky zhvillim.

2. VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

2.1. INXHINIERI E AMBIENTIT (BScIA)

Emri i Institucionit:	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Fakulteti/Departamenti:	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
Kampusi Kryesor dhe/apo Dega:	Kampusi Kryesor
Nëse aplikohet për Degë, ju lutem specifikoni Degën:	-
Emërtimi i Programit të Studimit:	Inxhinieri e Ambientit
Personi përgjegjës për Programin e Studimit:	Prof.Ass.Dr. Figene Ahmedi
Akreditim/Riakreditim:	Riakreditim
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	Niveli VI
Grada akademike apo emërtimi i gradës akademike në diplomë:	(BSc) Bachelor i Ndërtimtarisë – Programi Studimor: Inxhinieri e Ambientit
ECTS:	180
Profili i programit të studimit (specializimet):	-
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC):	06.04 (Ndërtimtari)
Forma e studimeve:	Studime të rregullta
Kohëzgjatja minimale e studimeve:	3 vjet
Numri i vendeve për studim:	40
Shëno Stafin e përhershëm shkencor/artistik për Programin e Studimit (së paku 3 PhD):	1.Prof.Ass.Dr. Figene Ahmedi, 2. Prof.Ass.Dr. Cenë Krasniqi, 3. Prof.Ass.Dr. Mimoza Dugolli

2.1.1. Misioni, objektivat dhe administrimi

Misioni i programit të studimit BScIA përputhet me deklaratën e përgjithshme të misionit të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës. Programi, është i orientuar në mësimdhënie, kërkime të vazhdueshme shkencore, hulumtime dhe në ofrim të një programi të dizajnuar për të përmbushur tri qëllimet kryesore të programit. Programi i studimit BScIA ka një koncept të mirë-përcaktuar didaktik dhe kërkimor. I gjithë stafi dhe studentët e programit të studimit BScIA janë në përputhje me rregulloret e brendshme që kanë të bëjnë me sjelljen etike në mësimdhënie, hulumtim dhe vlerësim në të gjitha aktivitetet akademike dhe administrative.

Programi ka për synim të arrijë këto tri qëllime kryesore: 1. Të edukojë gjenerata të inxhinierëve të ambientit ashtu që të adresojnë sfidat që lidhen me fushën e inxhinierisë së ambientit; 2. Të krijojë, zhvillojë dhe të përhapë njohuri të reja; 3. Të luaj rol udhëheqës në dhënie (ushqimin) e edukimit ndërdisiplinar, në mënyrë që të zgjidhen problemet me të cilat ballafaqohet shoqëria. Në fakt, strategjia e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (FNA) në lidhje me strukturën e studimeve dhe programin e studimit është që të ofrohet edukim i qartë duke krijuar kushte: për të qenë të hapur ndaj ideve të reja, për kreativitet, për t'u angazhuar për mësim gjatë gjithë jetës dhe për të qenë të qëndrueshëm. Programi i studimit BScIA është i orientuar kah përmbushja e qëllimeve të përgjithshme të FNA-së, duke ofruar lëndë me përmbajtje moderne dhe të përditësuara, e që janë fleksibile dhe lehtë të adaptueshme me kërkesat lokale, rajonale dhe globale të tregut.

Programi i studimit BScIA në kuadër të FNA-së ka personel administrativ në shërbim të stafit mësimdhënës, në përbërje të menaxhmentit dhe shërbimit të administratës, si: Dekani, Prodekani për çështje mësimore, Prodekani për financa, Sekretarin, Koordinatorin për zhvillime akademik, shërbimin studentor-referentët, shërbimin e TI dhe shërbimin teknik në laboratore. Shërbimet e mirëmbajtjes dhe sigurimit të hapësirave të brendshme të FNA-së,

përkatësisht të programit të studimit BScIA bëhen nga kompanitë e shërbimeve përkatëse, të jashtme dhe të përzgjedhura në nivel Universitar.

2.1.1.1. Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administratën:

A. Pikat e forta:

- Interes global për mbrojtje të ambientit.
- Objektivat edukuese përkrahin misionin e fakultetit dhe bazohen në nevojat e përmendura të programit.
- Është në harmoni me nevojat aktuale për ambient të shëndetshëm.
- Synon zhvillimin e kapaciteteve njerëzore që do të kontribuojnë në ruajtje dhe përmirësim të ambientit.
- Ofron lëndë që janë fleksibile dhe lehtë të adaptueshme me kërkesat lokale, rajonale dhe globale të tregut.

B. Dobësitë:

- Arritja e objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies edhe përmes aktiviteteve që plotësojnë nevojat e jetës sociale dhe kulturore.
- Mungesa e punëdhënësve potencial në fushat e inxhinierisë së ambientit.

C. Mundësitë:

- Plotësimi i objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies me aktivitete vullnetare.
- Krijimi i rrjetit të punëdhënësve potencial midis FNA-së dhe kompanive, e institucioneve të tjera relevante.

D. Sfidat:

- Krijimi i bërthamës menaxhuese/administrative për hartimin e projekteve kërkimore shkencore dhe profesionale në nivelin lokal, rajonal dhe global në fushat e inxhinierisë së ambientit.
- Krijimi, sigurimi i fondeve për infrastrukturë dhe paisje laboratorike adekuate.
- Krijimi i vendeve të reja të punës për mësimdhënës, asistentë dhe/ose shërbyes administrativ.

2.1.2. Menaxhimi i cilësisë

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (FNA) në bashkëpunim me mësimdhënësit organizojnë mësimdhënien, provimet dhe vlerësimet e studentëve. Përmes mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit BScIA, fakulteti, stafi dhe studentët tërhiqen të gjenerojnë njohuri dhe të zhvillojnë politika, teknika dhe aftësi, ashtu që të ndihmojnë praktikuesit të menaxhojnë edhe ndërtimin edhe burimet ambientale.

Për përcaktimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, si mënyra të vlerësimit të dijes, aplikohen: provime, kolokfiume, punime seminarike, përfshirë edhe interpretimin dhe prezentimin e tyre, praktika profesionale si dhe teste praktike gjatë ushtrimeve. Këto vegla

shfrytëzohen me qëllim që të vlerësohet se sa secili student ka arritur rezultatet e pritshme të nxënies në secilën lëndë.

Në nivel shumë bazik, vlerësimi i studentit në lëndën individuale referon nivelin e bartjes së suksesshme të njohurive të dëshiruara. Në nivel më të përgjithshëm, matjet, si p.sh. përqindja e pjesëmarrjes dhe përqindja e kalueshmërisë së studentëve në provime, po ashtu reflektojnë nivelin e arritjes së objektivave të programit.

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënësve bëhet përmes: vlerësimeve të brendshme nga vlerësimi vetanak, pyetësorëve dhe vetëvlerësimit nga ana e personelit akademik, (ashtu sic kërkohet të definohet edhe në Formularin e Komisionit Vlerësues për Emërimin e Personelit Akademik, për marrëdhënie pune në Institucionin Arsimor të Lartë, përfshirë edhe vlerësimin e punimeve shkencore (shih Uebfaqin: <https://www.uni-pr.edu/desk/inc/media/C15E46D5-5159-4E97-B8CB-D69734E39CA4.pdf>). Poashtu, vlerësimi bëhet edhe përmes pyetësorëve anonim të vlerësimit nga studentët përmes sistemit elektronik të menaxhimit të studentëve (SEMS), si dhe zhvillohet analizë e përmbushjes së detyrave (analiza e mbarëvajtjes së mësimin dhe rezultateve të mësimnxënies duke krahasuar me syllabusin e lëndës).

Në përmirësim dhe adaptim të kurrikulave kontribuon grupi punues për rishikim të programeve të studimit (studentë aktual, ish studentë dhe përgjegjës të programeve të studimit), si dhe bashkëpunimi me trupin këshilëdhënës që funksionon në kuadër të FNA-së e që përmban përfaqësues të kompanive në treg dhe stafi i fakultetit. Përmirësimi i vazhdueshëm poashtu ndodh në nivel programi dhe në nivel të lëndës individuale, bazuar edhe në rekomandime të ekspertëve të jashtëm për vlerësim të programit.

2.1.2.1. Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë:

A. Pikat e forta:

- Kolegialitet midis mësimdhënësve dhe marrëdhënie të mira student-fakultet si dhe traditë të gjatë për edukim dhe mentorim.
- Bashkëveprim i aryeshëm mësimdhënës/student gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Politika dhe teknika të aplikuara për vlerësim në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

B. Dobësitë:

- Informata jo të mjaftueshme për të dhënat e vlerësimit të brendshëm të procesit mësimor.
- Informimi jo i mjaftueshëm i stafit akademik për shpërndarje të angazhimit midis mësimdhënies, kërkimit dhe punëve administrative.
- Numri jo i mjaftueshëm i kuadrove për ushtrime.

C. Mundësitë:

- Bashkëpunimi me biznesin, tregtinë, industrinë, komunitetin punëdhënës për t'u mundësuar mësimdhënësve ngritjen e cilësisë së kurrikulës në kontekst të nevojave të tregut të punës.

D. Sfidat:

- Sigurimi i kuadrit të nevojshëm deri në kohën e rekrutimit.
- Plotësimi i vendeve të reja të punës për mësimdhënës, asistentë dhe/ose shërbim administrativ që ndihmon në kërkesën për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore.

2.1.3. Stafi akademik

Programi i studimit BScIA numëron githsej tridhjetë e shtatë mësimdhënës (profesorë dhe asistentë). Sipas titujve akademik, programi numëron nëntë Profesorë të rregullt (Prof. Dr.); Gjashtë Profesorë të Asocuar (Prof. Asoc. Dr.); Shtatë Profesorë asistentë (Prof. Ass. Dr.); Një Ligjërues (Ligj. Dr. sc.); Një Lektor (Lector); dhe Trembëdhjetë Asistentë (Ass.). Programi i studimit BScIA përkrahet edhe nga mësimdhënës, të cilët fushë interesi kanë çështjet që lidhen me ambientin. Programi përfshin mësimdhënës të cilët janë të trajnuar për metoda mësimdhënie si dhe për praktika të vlerësimit të studentëve në kontekst të mësimnxënies. Poashtu, në program, janë të përfshirë mësimdhënës si përfaqësues, shpesh në rolin udhëheqës në sektorë publik ambiental, në nivel vendi.

Stafi akademik, gjegjësisht mësimdhënësi është në disponueshmëri për kohë të mjaftueshme për t'ju ofruar studentëve këshilla atëherë kur ata kanë nevojë në lidhje me lëndën e caktuar. Mësimdhënësi u ofron studentëve tekstin, literaturën bazë mësimore, udhëzime për punime seminarike, si dhe për format e tjera të shfrytëzuara për mësimdhënie dhe mësimnxënie në kuadër të lëndës të cilën e zhvillon. Literaturë tjetër, ofrohet si literaturë shtesë nga mësimdhënësi për studentët të cilët shprehin interesim për studim më të hollësishëm gjatë studimeve në fushën me interes, apo për mësim gjatë gjithë jetës (life-long learning).

2.1.3.1. Analiza SWOT për stafin akademik:

A. Pikat e forta:

- Mësimdhënës të kualifikuar.
- Mësimdhënës të cilët fushë interesi kanë çështjet që lidhen me ambientin.
- Mësimdhënës të trajnuar për metoda mësimdhënie si dhe për praktika të vlerësimit të studentëve në kontekst të mësimnxënies.
- Mësimdhënësit e përfshirë në program, më herët si përfaqësues, shpesh në rolin udhëheqës në sektorë publik ambiental, në nivel vendi.

B. Dobësitë:

- Numri jo i mjaftueshëm i kuadrove për ushtrime.
- Kohëzgjatja e procedurës për angazhim të përkohshëm apo/dhe periodik të ekspertëve të fushës inxhinieri e ambientit nga tregu, industria apo shoqëria civile.

C. Mundësitë:


- Tregu ka potencial të mjaftueshëm të profesionistëve për asistentë të cilët kanë fushë të ngushtë të interesit çështjet që lidhen me inxhinierinë e ambientit.
- Sigurimi i kuadrove të mundshme deri në kohën e rekrutimit.

D. Sfidat:


- Sigurimi i kuadrove të mundshme deri në kohën e rekrutimit.
- Sigurimi i mbështetjes institucionale – financiare për ngritjen akademike dhe aktivitetin kërkimor të stafit mësimdhënës.
- Prgatitjet për hapjen e programit të studimit në nivelin master me përmbajtje të fushave të inxhinierisë së ambientit.

2.1.4. Përmbajtja e procesit arsimor

Programi i studimit i nivelit bachelor Inxhinieri e Ambientit (BScIA) shkon përtej të qenit vetëm inxhinieri teknike. Në këtë program, inxhinieria teknike dhe ajo ambientale nuk janë kundër njëra tjetrës, por ato bashkë ofrojnë zgjidhje. Programi i studimit BScIA kombinon grup lëndësh (shih grafiqet në vijim) si: lëndë themelore matematikore-natyrore, lëndë themelore të inxhinierisë së ndërtimit dhe ambientale. Në program një vend të rëndësishëm kanë edhe lëndët që paraqesin sinergji në mes inxhinierisë së ndërtimit dhe ambientit, duke kontribuar bashkë, si një, në një ambient të qëndrueshëm. Programi ofron edhe lëndë zgjedhore për njohuri shtesë nga po këto fusha dhe fusha jo teknike. Gjuha angleze përfshihet në program si e rëndësishme për botën e ndërlidhur globalisht për hulumtime dhe biznes. Lëndët e informatikës ofrojnë përkrahjen me kompjuter për ruajtjen, përpunimin dhe analizën e sasive të mëdha të të dhënave në kohë reale të inxhinierisë së ambientit, për të qenë në hap me zhvillimet në teknologji.



Grafik i grup lëndëve në programin e studimit BScIA



Grafik i pjesëmarrjes në përqindje të grup lëndëve në program

Programi i studimit të nivelit bachelor Inxhinieri e Ambientit (BScIA), është i krahasueshëm me Istanbul Technical University – Faculty of Engineering dhe ETH Swiss Federal Institute of Technology Zurich – Civil, Environmental and Geomatic Engineering Department. Si të tillë, ekspertët e jashtëm për vlerësim të programit (shih: Report of the expert team, 2015, në uebsajtin: <file:///C:/Users/Figene/Downloads/FR%20UP%20FNA%202015.pdf>) kanë

vlerësuar se përzgjedhja e lëndëve është bërë kujdesshëm dhe se ato korrespondojnë me kurrikulat moderne në inxhinierinë e ambientit. Studimet në programin e studimit BScIA janë studime të rregullta, zgjasin tri vjet (gjashtë semestra) dhe përmbajnë 180 kredi (ECTS), me nga 60 kredi secili vit.

Tabela me informatat për programin e studimit BScIA

Viti I						
Semestri: I			Orë/javë			
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1	O	Matematika I	2	2	6	Prof. Dr. Fevzi Berisha
2	O	Kimia e përgjithshme	2	2	6	Prof. Dr. Selim Isufi
3	O	Fizika	2	2	6	Prof. Dr. Rashit Maliqi
4	O	Hyrje në inxhinierinë e ambientit	2	2	6	Prof. Ass. Dr. Mimoza Dugolli
5	O	Hyrje në inxhinierinë e ndërtimit dhe ndikimi në ambient	2	0	3	Prof. Ass. Dr. Hajdar Sadiku
6	O	Gjuhë angleze	2	0	3	Osman Osmani, lekt.
Totali					30	
Semestri: II						
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1	O	Matematika II	2	2	6	Prof. Dr. Fevzi Berisha
2	O	Kimia e ambientit	2	2	6	Prof. Dr. Selim Isufi
3	O	Mekanika I	2	2	6	Prof. Ass. Dr. Hajdar Sadiku
4	O	Gjeometria deskriptive	2	2	6	Prof. Asoc. Dr. Arta Basha-Jakupi
5	O	Hyrje në informatikë dhe programim	2	2	6	Prof. Ass. Dr. Kadri Sylejmani
Totali					30	

Sqarim: Numri total i kredive (ECTS) të akumuluarra për një vit është 60 ECTS – kredi.

Nga 11 lëndët obligative fitohen gjithsej 60 ECTS – kredi.

Viti II						
Semestri: III			Orë/javë			
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1	O	Termodinamika e inxhinierisë	2	2	6	Prof. Dr. Xhemajl Fejzullahu
2	O	Mikrobiologjia ambientale	2	2	6	Prof. Dr. Idriz Vehapi

3	O	Materialet e ndërtimit	2	2	6	Prof. Ass. Dr. Cenë Krasniqi
4	O	Gjeologjia inxhinierike	2	1	3	Prof. Dr. Islam Fejza
5	O	Meteorologjia	2	1	3	Prof. Dr. Sylë Tahirsylaj
6	Z	Sigurimi i shëndetit	2	0	3	Prof. Dr. Selvete Krasniqi
7	Z	Ekonomia në inxhinieri	2	0	3	Prof. Ass. Dr. Mimoza Dugolli
8	Z	Probabiliteti dhe statistika	2	1	3	Prof. Dr. Fevzi Berisha
Totali					30	

Semestri: IV

Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1	O	Mekanika e fluideve	2	2	6	Prof. Assoc. Dr. Laura Kusari
2	O	Hidrologjia	2	2	6	Prof. Assoc. Dr. Naim Hasani
3	O	Mekanika e dherave	2	2	6	Prof. Ass. Dr. Qani Kadiri
4	O	Menaxhimi i ujit urban	2	2	6	Prof. Assoc. Dr. Figene Ahmedi
5	Z	Projektimi i deponive	2	1	3	Prof. Ass. Dr. Qani Kadiri
6	Z	Hartografia	2	0	3	Prof. Ass. Dr. Bashkim Idrizi
7	Z	Kontrollimi i ndotjes së ajrit	2	1	3	Prof. Assoc. Dr. Ferat Shala
8	Z	Ligji mbi mbrojtjen e ambientit	2	0	3	Prof. Ass. Dr. Mimoza Dugolli
Totali					30	

Sqarim: Numri total i kredive (ECTS) të akumuluarra për një vit është 60 ECTS – kredi.

Nga 9 lëndët obligative fitohen gjithsej 48 ECTS, nga 7 lëndë zgjedhore studenti është i obliguar t'i (t'a) zgjedh 4 lëndë, gjegjësisht 12 ECTS – kredi.

Pas zgjedhjes së lëndës zgjedhore ajo shndërrohet në lëndë obligative, studenti nuk do të mund ta ndërroj lëndën dhe as Profesorin.

Viti III						
Semestri: V			Orë/javë			
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1	O	Analiza e të dhënave të ambientit	2	2	6	Dr. Sc. Skender Bublaku
2	O	Menaxhimi i mbeturinave të ngurta	2	2	6	Dr. Sc. Skender Bublaku
3	O	Teknologjitë e trajtimit të ujit të ndotur	2	2	6	Prof. Assoc. Dr. Figene Ahmedi
4	O	Mbrojtja dhe përforcimi i dherave	2	2	6	Prof. Ass. Dr. Qani Kadiri

5	Z	Vlerësimi i ndikimeve ambientale	2	0	3	Prof. Asoc. Dr. Ferat Shala
6	Z	Energjia dhe ambienti	2	0	3	Prof. Ass. Dr. Mimoza Dugolli
7	Z	Menaxhimi i projekteve	2	0	3	Dr. Sc. Skender Bublaku
8	Z	Mbrojtja nga vërshimet	2	1	3	Prof. Asoc. Dr. Laura Kusari
Totali					30	

Semestri: VI

Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1	O	Sistemet fushore të trajtimit të ujërave të ndotura	2	2	6	Prof. Asoc. Dr. Figene Ahmedi
2	O	Ndikimi i planifikimit urban në ambient	2	2	6	Prof. Ass. Dr. Mimoza Dugolli
3	O	GIS në ambient	2	1	3	Prof. Asoc. Dr. Përparim Ameti
4	Z	Materialet polimere dhe aplikimet në inxhinierinë e ambientit	2	1	3	Prof. Dr. Naser Kabashi
5	Z	Hidrogeologjia	2	1	3	Prof. Asoc. Dr. Naim Hasani
6	Z	CAD	2	0	3	Prof. Asoc. Dr. Arta Basha-Jakupi
7	Z	Ekologjia e përgjithshme	2	0	3	Prof. Ass. Dr. Bekim Gashi
8	Z	Punë praktike - Internship	/	/	3	Kompani bashkëpunimi
	O	Punim diplome	/	/	9	
Totali					30	

Sqarim: Numri total i kredive (ECTS) të akumuluarra për një vit është 60 ECTS – kredi.

Nga 7 lëndët obligative fitohen gjithsej 39 ECTS, nga Punimi i Diplomes studenti fiton 9 ECTS, nga 9 lëndë zgjedhore studenti është i obliguar t'i (t'a) zgjedh 4 lëndë, gjegjësisht 12 ECTS – kredi. Pas zgjedhjes së lëndës zgjedhore ajo shndërrohet në lëndë obligative, studenti nuk do të mund ta ndërroj lëndën dhe as Profesorin.

Sipas statusit të UP-së, për çdo 1 ECTS kalkulohej 25 orë studimi. Një shembull i kalkulimeve të ngarkesës së studentit që reflekton se si i caktohen 3 ECTS për një lëndë shihet në tabelën në vijim.

Shembull i përcaktimit të ngarkesës së studentit

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsejt
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			

Puna praktike	2	15	30
Përgatitje për test intermediar			
Konsultimet me mësimdhënësin	0.5	6	3
Puna në terren	2	1	2
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			3
Përgatitja për provim final			4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			3
Projektet, prezantimet, etj.			
Totali			75

2.1.4.1. Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit arsimor:

A. Pikat e forta:

- Ndërdisciplinartet.
- Kombinim i grup lëndëve si: lëndë themelore matematikore-natyrore, lëndë themelore të inxhinierisë së ndërtimit dhe ambientale, lëndë që paraqesin sinergji në mes inxhinierisë së ndërtimit dhe ambientit, dhe lëndë zgjedhore për njohuri shtesë nga po këto fusha dhe fusha jo teknike.
- Lëndë korresponduese me kurrikula moderne në inxhinierinë e ambientit.
- Program me përmbajtte të lëndëve që u mundëson studentëve të UP-së të jenë konkurentë me studentë të Universiteteve të Rajonit dhe Universiteteve Ndërkombëtare.

B. Dobësitë:

- Procedura të ngadalsuara administrative në rastin e rivlerësimit të kurrikualve.
- Mungesa e laboratoreve të disa fushave të inxhinierisë së ambientit, brenda FNA-së.

C. Mundësitë:

- Fleksibiliteti për të inkorporuar ide dhe koncepte të reja në kurrikulë të cilat shpërfaqen nga procesi vlerësues (në vijim).
- Shfrytëzimi i bashkëpunimeve midis FNA-së dhe institucioneve publike, organizatave dhe Fakulteteve të tjera brenda UP-së për shfrytëzim të laboratoreve.
- Bashkëpunimi midis programeve të studimit BScIA dhe masterit profesional eficientë e energjisë për fushat përkatëse.
- Mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve në Universitete Ndërkombëtare në fushën e inxhinierisë së ambientit.

D. Sfidat:

- Zgjerimi i programit të studimit në nivelin master për të krijuar kuadro të inxhinierisë së ambientit.

- Mungesa e sigurimit financiar vetanak e programit të studimit.

2.1.5. Studentët

Programi i studimit i nivelit bachelor Inxhinieri e Ambientit (BScIA) u dedikohet kandidatëve të cilët kanë kryer me sukses shkollimin e mesëm, që janë të interesuar për studime universitare dhe të cilët mendojnë “të bëjmë dicka për ambientin”.

Pranimi i studentëve në programin e studimit BScIA kryhet përmes thirrjes publike, për nënshtrim në provim pranues në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (FNA). Kriteret pranuese për nivelin Bachelor janë të specifikuara në thirrjen publike. Senati i Universitetit është përgjegjës për numrin e kandidatëve që do të pranohen në vitin e parë, duke konsideruar numrin e propozuar nga Këshilli i Fakultetit për programin e studimit BScIA.

Studentët e Inxhinierisë së Ambientit zhvillojnë studimet sipas planit me lëndë të përfshira në programin e studimit BScIA dhe i nënshtrohen vlerësimeve sipas politikave të krijuara nga FNA dhe UP në përgjithësi. Po ashtu, studentët e programit të studimit BScIA, gjatë ciklit të studimeve kanë mundësinë të vizitojnë kompani industriale, impiante trajtimi të ujit dhe ujit të ndotur, deponi, laboratore, etj., me qëllim që të informohen se si ato operojnë, se si i elaborojnë të dhënat mbi p.sh. ndryshimet klimatike, kualitetin e ujit, etj. Vizitat studimore e poashtu edhe realizimi i pjesës praktike të lëndës së caktuar, realizohen në kuadër të marrëveshjeve bashkëpunuese midis FNA-së me institucionet (organizatat) lokale.

Në fakt, në kuadër të programit përfshihet edhe lënda Punë praktike. Puna praktike u mundëson studentëve që të zhvillojnë praktikë profesionale të organizuar nga bartësi i lëndës me kompanitë, organizatat dhe institucionet profesionale, relevante me fushën e inxhinierisë së ambientit. Në vijim janë pasqyruar disa nga institucionet/departamentet dhe kompanitë, në të cilat studentët mund të zhvillojnë Punën praktike.

- Departamenti për mbrojtje të mjedisit – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH)
- Sektori për monitorim të mjedisit – Agjensioni për Mbrojtje të Mjedisit në Kosovë (AMMK)
- Kompania rajonale e ujësjellësit “Hidrodrini” – Pejë
- Kompania rajonale e ujësjellësit “Prishtina” – Prishtinë
- Zyra për mjedis/Departamenti për shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim – Komuna e Prishtinës
- Departamenti i urbanizmit – Komuna e Drenasit

Inxhinieria e Ambientit përgatit studentë për karrierë profesionale dhe studime të mëtejme në fushën e inxhinierisë së ambientit. Inxhinierët e ambientit kuptojnë dhe inkorporojnë konceptet e inxhinierisë së ndërtimit, ambientit, ekonomisë, politikës dhe shkencave shoqërore për shërbim në komunitet përmes participimit dhe përgjegjësisë si teknikë ambiental në aktivitetet profesionale dhe shoqërore. Inxhinierët e ambientit, si multidisciplinorë ofrojnë zgjidhje në

problemet ambientale si në: menaxhimin urban të ujit, mbrojtjen e ujit nga ndotja, teknologjitë e trajtimit të ujit, riciklimin dhe menaxhimin e mbeturinave dhe inxhinieri të deponive, mbrojtje të dherave, planifikimin e aktiviteteve njerëzore kundrejt ambientit dhe në kontrollimin e ndotjes së ajrit. Më konkretisht, pas përfundimit me sukses të këtij programi, studentët do të jenë të aftë të:

- Aplikojnë njohuri të matematikës dhe inxhinierisë në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.
- Analizojnë dhe interpretojnë të dhëna.
- Arsyetojnë rëndësinë e ambientit për shoqërinë.
- Identifikojnë, formulojnë dhe zgjidhin probleme në fushën e: menaxhimit të ujit urban, mbrojtjes së ujit nga ndotja, teknologjisë së trajtimit të ujit, riciklimit të mbeturinave dhe inxhinierisë së deponive, mbrojtjes së dherave dhe kontrollë të ndotjes së ajrit.
- Kuptojnë ndikimin e zgjidhjeve inxhinierike në kontekst ambiental dhe shoqëror.
- Luajnë rol kritik për të adresuar sfidat e ndotjes së ujit, tokës dhe ajrit.

Në fund të studimeve, studenti punon temën e diplomës duke vërtetuar të arrituarit e të mësuarit dhe aplikimin e informative të fituara gjatë studimeve lidhur me fushat me interes të inxhinierisë së ambientit. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve të nivelit bachelor në programin e studimit Inxhinieri e Ambientit fitohet thirrja akademike “Bachelor i Ndërtimtarisë” në programin e studimit Inxhinieri e Ambientit.

Në kuadër të programeve të bashkëpunimit shkencor dhe arsimor të Universitetit të Prishtinës me Universitete të tjera Ndërkombëtare, edhe Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës me të gjitha programet studimore i mundësohen studime në çfarëdo fushe të interesit me bursa për nivele studimore: bachelor, master apo doktrate. Nga këto programe bashkëpunimi për vazhdim të studimeve master, kanë përfutur edhe studentë të programit të studimit BScIA. Përmes programit ERASMUS + Mobility të Komisionit Evropian, studentëve të interesuar u ofrohen bursa mobiliteti në Universitete Ndërkombëtare, në departamente të lidhura me fushat e Inxhinierisë së Ambientit, si:

- Middle East Technical University, Turqi – Faculty of Engineering (2017, 2018)
- Silesian University of Technology - SUT, Gliwice, Poloni (2018), dhe të tjera të ofruara

(shih në faqen Bursa Studimi, në Uebsajtin e UP-së: <https://www.uni-pr.edu/>).

Mobilitetet akademike për studentë janë të rregulluara përmes politikave të UP-së (shih në faqen Zyra për Marrëdhënie me Jashtë, në Uebsajtin e UP-së: <https://www.uni-pr.edu/>).

Për t’u informuar rreth arritjeve shkencore, studentët kanë çasje në librarinë digjitale “Science Direct”, të shtëpisë botuese me renome – Elsevier (shih në faqen ScienceDirect, në Uebsajtin e UP-së: <https://www.uni-pr.edu/>). Së fundi (nga Dhjetori i 2018), studentët kanë mundësi të gjejnë materiale elektronike edhe në Bilblotekën Qendrore Kombëtare përmes platformës LibApps të krijuar nga Universiteti i Prishtinës në kuadër të projektit Erasmus +, “Library Network Support Services”.

2.1.5.1. Analiza SWOT për studentët:

A. Pikat e forta:

- Aktivitetet e studentëve në kuadër të kurrikulës janë kompatible me aktivitetet në kurrikulat ndërkombëtare të fushës.
- Nuk ka student që braktis studimet.
- Studentë konkurentë me studentë të Universiteteve të Rajonit dhe Universiteteve Ndërkombëtare në fushën e inxhinierisë së ambientit.
- Çasje në revista shkencore përmes librarisë digjitale ScienceDirect të ofruara nga UP-ja.

B. Dobësitë:

- Mungesa e programit të studimit në nivelin master.
- Pamjaftueshmëri e përfshirjes së studentëve në projekte hulumtuese.

C. Mundësitë:

- Hapja e programit të studimeve në nivelin master (apo nivel master që integron dy programe të studimit: Inxhinierinë e Ambientit dhe Hidroteknikën).
- Krijimi i mundësive të reja për inxhinierë të ambientit, duke promovuar ndërdisiplinartet, përmes punës praktike, rrjetit të punëdhënësve.
- Inxhinierët e ambientit mund të bëhen pjesë e proceseve vlerësuese të inxhinierisë ambientale.
- Mobilitet i studentëve përmes projekteve hulumtuese në Universitete Ndërkombëtare në fushën e inxhinierisë së ambientit.

D. Sfidat:

- Vazhdimi i studimeve në nivelin master.
- Promovimi i vlerës së inxhinierit të ambientit në institucione dhe organizata të fushës.
- Praktika ndërkombëtare.

2.1.6. Hulumtimi

Mësimdhënësit e përfshirë në programin e studimit të nivelit bachelor Inxhinieri e Ambientit (BScIA) janë të përzgjedhur përmes politikave të hartuara nga Universiteti i Prishtinës. Kjo do të thotë se, mësimdhënësit e përfshirë, përpos kriterëve të tjera të kërkuara, plotësojnë edhe kriterin e publikimit të punimeve shkencore në revista ndërkombëtare, të cilat janë në pajtueshmëri me Udhëzuesin Administrativ mbi parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension (shih Uebfaqin: <https://www.uni-pr.edu/desk/inc/media/C15E46D5-5159-4E97-B8CB-D69734E39CA4.pdf>). Hulumtimet e mësimdhënësve, i mundësojnë programit në veçanti dhe Fakultetit në përgjithësi sjelljen e po asaj eksperience hulumtimi në klasë si burim i problemeve të botës reale dhe çështjeve të kohës (bashkëkohore).

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (FNA) ka arritur që përmes projektit shkencor “InWaterSense” (Intelligent Wireless Sensor Networks for Monitoring Surface Water Quality), të financuar nga Unioni Evropian (EU) (shih Uebfaqin: <https://inwatersense.uni-pr.edu/>) të realizojë bashkëpunim midis hulumtuesve në Kosovë nga fusha të ndryshme, si: Hidroteknika, Inxhinieria Kompjuterike, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe nga Universitetet partnere të EU-së, të përfshira në projekt, si: Universiteti Teknik i Vjenës, Instituti Tyndall dhe Universiteti Linnaeus. Projekti “InWaterSense” ka ofruar mundësi publikimi të punimeve shkencore të përbashkëta midis partnerëve të përfshirë në projekt. Poashtu, projekti “InWaterSense” ka mundësuar që FNA-ja të jetë bartëse e disa paisjeve laboratorike (mostruesin automatik-autosampler dhe sensorët mobil për analizë të kualitetit të ujit) në shërbim edhe të studentëve të programit të studimit BScIA si p.sh. për punim të temës së diplomës.

Niveli bachelor i programit të studimit BScIA përmbyllet me punimin e temës së diplomës e cila është kryesisht punë hulumtuese individuale. Puna e temës së diplomës mund të organizohet edhe nga grup studentësh për hulumtim në një fushë të caktuar. Një pjesë e hulumtimit planifikohet të zhvillohet në bashkëpunim me kompaninë relevante me subjektin e temës. Kontakti bashkëpunues midis studentit dhe kompanisë mund të arrihet edhe me ndihmën e trupit këshilldhënës në kuadër të FNA-së, por edhe përmes bashkëpunimeve të arritura në kuadër të punës praktike.

Si rrjedhojë e kontaktit përmes punës praktike, grup studentësh të programit kanë zhvilluar një projekt (workshop) në lidhje me përmirësimin e ajrit në qytetin e Prishtinës. Projekti është realizuar në bashkëpunim me UPSHIFT, UNICEF Kosovo’s Innovations Lab, si dhe me Komunën e Prishtinës. Inxhinierët e Ambientit përmes projektit (workshop-it) të titulluar “Te Pema” jo vetëm që kanë shtyer ide për përmirësim të ajrit në qytete me ndotje të madhe (shih Uebfaqin: <http://kosovoinnovations.org/fighting-air-pollution-with-innovation-arlindas-quest-for-a-cleaner-prishtina/?fbclid=IwAR2Eni4TxGDWgBZVUbw5civMRBzgNxYJ-G7yQcyN-GCVENML6B9SB0Q8YU>), por po ashtu kanë treguar përmëshje të qëllimeve të programit si dhe të arritura në mësimnxënie dhe në menaxhim të cilësisë së programit të studimit të nivelit bachelor Inxhinieri e Ambientit.

2.1.6.1. Analiza SWOT për hulumtim:

A. Pikat e forta:

- Publikime të hulumtimeve në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, në shërbim të shkencës, arsimit dhe teknologjisë për shoqërinë.
- Shfrytëzim i rasteve studimore (nga hulumtimet) si burime të problemeve reale dhe çështjeve të kohës (bashkëkohore) për zgjidhjen e problemeve në kuadër të fushës.

B. Dobësitë:

- Mungesa e laboratoreve për disa fusha të inxhinierisë së ambientit, brenda FNA-së.
- Nxitja për publikime nga politikat e UP-së, dhe mbështetje jo e mjaftueshme financiare nga UP-ja për hulumtime.

- Bashkëpunimi jo i mjaftueshëm me biznesin, industrinë, vendimarrësit dhe komunitetin punëdhënës për projekte hulumtuese dhe/ose profesionale.

C. Mundësitë:

- Rritja e burimeve financiare për mbështetje të stafit akademik për hulumtime dhe publikime.
- Bashkëpunimi me biznesin, tregtinë, industrinë, komunitetin punëdhënës, për të mundësuar zhvillimin e projekteve hulumtuese dhe/ose profesionale.
- Informimi për të arriturat e fundit të fushës përkatëse të inxhinierisë së ambientit edhe përmes të tjera librarive digjitale, përpos ScienceDirect të ofruar nga UP-ja.
- Sigurimi i mjeteve financiare përmes projekteve shkencore/proesionale për fushën e inxhinierisë së ambientit.

D. Sfidat:

- Zhvillimi i mundshëm i hulumtimeve përmes financimit vetanak, apo përmes projekteve hulumtuese në të cilat duhet aplikuar.
- Sigurimi i fondeve përmes projekteve shkencore/proesionale për fushën e inxhinierisë së ambientit.
- Çasje në të dhënat në fushat përkatëse të inxhinierisë së ambientit, nga institucionet vendore, për hulumtim.

2.1.7. Infrastruktura dhe burimet

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës posedon dy hapësira të ndara fizikisht, si të veçanta për zhvillim të procesit mësimor. Njëra hapësirë i takon Departamentit të Ndërtimtarisë dhe tjetra Departamentit të Aritekturës. Departamenti i Ndërtimtarisë ofron hapësirë të mjaftueshme për zhvillim të mësimdhënies (1200 m²), përfshirë edhe programin e studimit BScIA. Në këtë hapësirë të FNA-së, në shërbim edhe të programit të studimit BscIA, zënë vend: zyret e menaxhmentit, zyret e administratës, sallat e mësimi, labororet (në objekt të veçantë, me sipërfaqe të labratoreve dhe hapësirave përcjellëse të tyre prej 1268 m², janë labororet: i mekanikës së fluideve, i gjeomekanikës, i materialeve të ndërtimit), biblioteka, si dhe korridoret, nyjet sanitare dhe zyre të tjera ndihmëse. Zyret e menaxhmentit, administratës dhe zyret e mësimdhënësve janë të paisura me kompjuterë e printerë. Poashtu, ekzistojnë klasë të pajisura me kompjuterë të dedikuar për lëndë të caktuara. Në pronësi të FNA-së (në objektin e labratoreve) janë edhe 2000 m² të cilat janë të renovuara dhe të përgatitura për zhvillimin e aktiviteteve shtesë të këtij programi të studimit.

2.1.7.1. Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet:

A. Pikat e forta:

- Hapësirë e mjaftueshme për zhvillim të procesit mësimor.
- Hapësirë e mjaftueshme për krijim të laboratorit.
- Mundësi në librari digjitale ScienceDirect.
- Mundësi për shfrytëzimin e labratoreve të Institutit INKOS sic janë: Laboratori i gjeomekanikës për shqyrtime të vetive fiziko-mekanike të trolit, Laboratori për

analiza të naftës dhe derivateve të saj si dhe vajit industrial, Laboratori për analiza të mineraleve, Laboratori për analiza të ujit, Laboratori për analiza mikrobiologjike të ujit, Laboratori për analiza të ajrit (marreveshja ne shtojcen elektronike: Dokumente)

B. Dobësitë:

- Pamjaftueshmëri e shrytëzimit të laboratoreve të institucioneve të tjera për zhvillim të pjesëve praktike të lëndëve të caktuara dhe për hulumitme.
- Numri jo i mjaftueshëm i teksteve të fushës në bibliotekë.
- Pamjaftueshmëri e mirëmbajtjes së hapësirave për aktivitetet e procesit të mësimimit.

C. Mundësitë:

- Krijimi i laboratorit në hapësira të FNA-së, dedikuar fushave të inxhinierisë së ambientit.
- Krijimi i një laboratorit të vetëm (p.sh. për analiza të cilësisë së ujit) brenda UP-së në shërbim të nevojave të përbashkëta për të gjitha fakultetet.

D. Sfidat:

- Sigurimi i fondeve për krijimin e laboratoreve përmes projekteve hulumtuese.
- Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për hulumtim dhe mësimdhënie, me qëllim të furnizimit të bibliotekës me libra dhe laboratoreve me pajisje.

2.1.8. Përshkrimet e shkurta të lëndëve në kuadër të Programit Inxhinieri e Ambientit (BSc)

Titulli i lëndës:	Matematika I												
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda ka të bëjë me njohuri nga matematika që janë të nevojshme për lehtësimin e fitimit të njohurive nga lëndët tjera dhe zbatimin e njohurive në inxhinierin e ambientit. Paraqiten elementet e nevojshme nga bashkësitë numerike sidomos nga bashkësia e numrave realë. Njohurit nga matrica dhe përcaktorët që janë të nevojshme për zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve lineare. Metodat për zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve. Sistemet e ekuacioneve në forma dhe mënyra të ndryshme. Elementet e gjeometrisë analitike në hapësirë. Kuptimi i vektorit, veprimet lineare dhe jolineare me vektorë. Ekuacioni i drejtzës dhe rrafshit në hapësirë. Ekuacionet e shkallës së dytë-Sipërfaqet												
Qëllimet e lëndës:	Njoftimi me njohuritë nga matematikë të nevojshme për aplikimin në shkencën e teorisë së matjeve të faktorëve të ambientit.												
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje që të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet e matematikës së lartë, me qëllim që ato njohuri ti ndihmojnë si aparat ndihmës në lëndët në të cilat është i domosdoshëm përdorimi aparatit matematikor. Studentët duhet të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> - të zbatojnë bashkësitë numerike në shqyrtimet dhe prezantimin e kuptimeve tjera si nga algebra ashtu edhe nga analiza matematike - të njoh kuptimin e matricës dhe përcaktorëve si dhe të vërtetoi vetit e përcaktorëve të cilat zbatohen për zgjidhjen e sistemit të ekuacioneve - të zgjidh sistemet e ekuacioneve në forma dhe mënyra të ndryshme - të njoh kuptimin e vektorit, veprimet si lineare ashtu edhe jo lineare me vektor si dhe ti zbatoi vetit e veprimeve me vektor në shkencat mekanikës teknike - të paraqes forma të ndryshme të ekuacionit të rrafshit të drejtzës në hapësirë si dhe pozitat reciproke të tyre - të paraqes në formë gjeometrike dhe analitike format e sipërfaqeve në hapësirë 												
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Lënda ka rëndësi të veçantë sidomos në aplikimin në problemet e inxhinierisë së ambientit. Aktualitet në zbatimin e teknologjive të informacionit.												
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimin duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale												
Metodat e vlerësimit:	<table border="0"> <tr> <td>Vlerësimi i parë</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Vlerësimi i dytë</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Angazhimi në ushtrime</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Vijimi i rregullt</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Provimi final</td> <td>40%</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>100%</td> </tr> </table>	Vlerësimi i parë	20%	Vlerësimi i dytë	20%	Angazhimi në ushtrime	10%	Vijimi i rregullt	10%	Provimi final	40%	Total	100%
Vlerësimi i parë	20%												
Vlerësimi i dytë	20%												
Angazhimi në ushtrime	10%												
Vijimi i rregullt	10%												
Provimi final	40%												
Total	100%												
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fevzi Berisha-Abdullah Zejnullahu: Matematika- për arkitekturë , 1996, Prishtinë. 2. Fevzi Berisha: Përmbledhje detyrash të provimit nga matematika1,2, Prishtinë 2006. 												
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ejup Hamiti – Matematika I, II. Elektro - Prishtinë 2. Isak Hoxha – Matematika I,I Ndërtimtari, Prishtinë 3. Ismet Dehiri – Matematika I,II Fakultet Teknik, Prishtinë 4. Përmbledhje të ndryshme të detyrave 5. Interneti 												

Titulli i lëndës:	Kimia e përgjithshme																					
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda e kimisë së përgjithshme është e nevojshëm për studentët e inxhinierisë mjedisore, sepse siguron bazat e nevojshme në kimi për të ndjekur një karrierë në inxhinierinë mjedisore. Ky është një kurs bazik i nivelit universitar për kimi, i cili përfshinë strukturën e materies, ndërtimin e atomit, elementet dhe komponimet kimike, masën dhe energjinë, relacioni i tyre në reaksionet kimike, ligjin periodik dhe strukturën elektronike të atomit, lidhjet kimike, gazet reale dhe ideale, ujin dhe tretësirat ujore, strukturën kristalore, kinetikën dhe ekuilibrin kimik, kiminë e dukurive sipërfaqësore, elektrolitet, joelektrolitët, bazat e elektrokimisë, njohuri të përgjithshme për grupet kryesore të elementeve kimike.																					
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i kursit të kimisë së përgjithshme është që të përgatisë studentët për të vijuar studimet në lëndët e kimisë mjedisore dhe lëndëve të afërta me fushën e kimisë të rëndësishme për inxhinierinë mjedisore të cilat do të mbahen në semestrat në vijim. Ky kurs ka për qëllim të pajisë studentët e inxhinierisë mjedisore me konceptet bazë dhe me parimet më të rëndësishme të kimisë. Janë disa arsye pse studentët e inxhinierisë mjedisore duhet të mësojnë kiminë si objektiv specifik i të nxënit. Disa nga këto objektiva merren me tema apo teknika të veçanta të nevojshme për inxhinierinë e mjedisit. Qëllimi kryesor i këtij kursi ka të bëjë me tepër me raportet e përgjithshme midis kimisë si shkencë natyrore dhe inxhinierisë mjedisore se sa me detajet e veçanta të parimeve kimike.																					
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Me përfundimin e suksesshëm të këtij kursi studentët duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ përdorin njohuritë e strukturës së molekulave dhe vetitë e tyre në përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve teknologjike reale; ✓ shpjegojnë dhe të vlerësojnë lidhje në mes të eksperimentit dhe teorisë në shkencë në përgjithësi dhe të kimisë në veçanti; ✓ demonstrojnë shkathtësi të kënaqshme për zgjidhjen e problemit në shumë aspekte të kimisë, duke përfshirë stekiometrinë, termokiminë, baraspeshën kimike dhe kinetikën e reaksioneve kimike; ✓ përshkruajnë bazat teorike moderne për kuptimin e fushave të rëndësishme të kimisë, duke përfshirë strukturën atomike, lidhjet kimike, dhe strukturën e molekulës. 																					
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratë, punë laboratorike, punë seminarike dhe individuale.																					
Metodat e vlerësimit:	<table style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 60%;">Vlerësimi i parë:</td> <td style="text-align: right;">25%</td> </tr> <tr> <td>Vlerësimi i dytë:</td> <td style="text-align: right;">30%</td> </tr> <tr> <td>Detyrat e shtëpisë dhe seminarët:</td> <td style="text-align: right;">5%</td> </tr> <tr> <td>Vijimi i rregullt:</td> <td style="text-align: right;">5%</td> </tr> <tr> <td>Provimi final:</td> <td style="text-align: right;">35%</td> </tr> <tr> <td>Total:</td> <td style="text-align: right;">100%</td> </tr> <tr> <td colspan="2">Vlerësimi final me note do të bëhet si vijon:</td> </tr> <tr> <td>51%- 60% = 6</td> <td>61% -70% = 7</td> </tr> <tr> <td>71% - 80% = 8</td> <td>81% - 90% = 9</td> </tr> <tr> <td>91%-100% =10</td> <td></td> </tr> </table>		Vlerësimi i parë:	25%	Vlerësimi i dytë:	30%	Detyrat e shtëpisë dhe seminarët:	5%	Vijimi i rregullt:	5%	Provimi final:	35%	Total:	100%	Vlerësimi final me note do të bëhet si vijon:		51%- 60% = 6	61% -70% = 7	71% - 80% = 8	81% - 90% = 9	91%-100% =10	
Vlerësimi i parë:	25%																					
Vlerësimi i dytë:	30%																					
Detyrat e shtëpisë dhe seminarët:	5%																					
Vijimi i rregullt:	5%																					
Provimi final:	35%																					
Total:	100%																					
Vlerësimi final me note do të bëhet si vijon:																						
51%- 60% = 6	61% -70% = 7																					
71% - 80% = 8	81% - 90% = 9																					
91%-100% =10																						
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Filipovic - Lipanovic; Kimia e përgjithshme, (përkthim Xh. Ahmeti) Prishtinë, 1996. 2. Si literaturë e bazë e kursit do të jenë ligjëratat e autorizuara nga mësimdhënësi. 																					
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mujë Rugova & Tahir Gjecbitriqi: Kimia Inorganike, Prishtinë 1998. 2. R.Petruci, F.Herring, J.Maduro, C.Bissonnette: General Chemistry-Principles and Modern Application, 10th edition, USA, 2011. 3. Larry Brown, Tom Holme; Chemsitry for Engineering Students, 2nd edition, USA 4. J. Mc.Murry and R. Fay, Chemistry, 4th edition, New Jersey, USA, 2004. 																					

Titulli i lëndës:	Hyrje në inxhinierinë e ambientit
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Kjo është një lëndë fundamentale për studentet e vitit të parë. Përmes kësaj lënde studentet do të njoftohen për principet e qëndrueshmërisë, në fushën e inxhinierisë ambientale. Gjatë kësaj klase, studentet do të aplikojnë këto principe në problemet inxhinierike në mënyrë që të mund të bëjnë vlerësim të implikimeve mjedisore, ekonomike dhe sociale në inxhinieri dhe sfidave për marrjen e vendimeve. Temat do të përfshijnë definicionet e qëndrueshmërisë, sfidat kryesore inxhinierike (shembull: uji, energjia, klima, dhe materialet), gjenerimin e ndotjes, mbrojtjen dhe mjetet për vlerësimin e qëndrueshmërisë (vlerësimi i ciklit të jetës)
Qëllimet e lëndës:	Në fund të kësaj lënde, student do të mund të: <ol style="list-style-type: none"> 1. Definojnë qëndrueshmërinë se si aplikohet në problemet inxhinierike. 2. Përkrahin sfidat kryesore në inxhinieri (ujin, energjinë, klimën, materialet, etj). 3. Kalkulojnë dhe balancojnë materialet dhe qarkullimin e energjisë nëpër fazat e shumëfishta të sistemeve inxhinierike. 4. Përkrahin mekanizmat e ndikimeve në mjedis për shkak të ndotjes (smog, shkatërrimi i ozonit, eutrofikimi, etj) 5. Interpretimi i rezultateve të vlerësimit të ciklit të jetës dhe rekomandimi i zgjedhjeve potenciale të problemeve inxhinierike. 6. Krahasimi i sistemeve inxhinierike dhe arsyetimi i vendimeve inxhinierike bazuar në rezultatet e vlerësimeve të qëndrueshmërisë duke identifikuar dhe përshkruar ndikimet relevante mjedisore, ekonomike, dhe sociale.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të kësaj lënde studentet do të jenë aftësuar për të kuptuar dhe adresuar sfidat në inxhinierinë e ambientit, marrin vendime në bazë të rezultateve të vlerësimeve të qëndrueshmërisë, kalkulojnë dhe balancojnë materialet dhe qarkullimin e energjisë nëpër fazat e shumëfishta të sistemeve inxhinierike.
Metodat e mësimdhënies:	Lënda do të zhvillohet përmes ligjeratave të rregullta dhe disa ushtrimeve të zgjedhura në klase
Metodat e vlerësimit:	Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 35% Vlerësimi i dytë: 35 % Angazhimet në detyrat (shtëpisë) 30% Provimi final
Literatura primare:	James R. Mihelcic Julie B. Zimmerman “Environmental Engineering: Fundamentals, Sustainability, Design”, second edition. Other texts as provided during the lectures
Literatura shtesë:	Tom Theis & Jonathan Tomkin “Sustainability: A Comprehensive Foundation”

Titulli i lëndës:	Hyrje në inxhinierinë e ndërtimit dhe ndikimi në ambient
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda: Inxhinieri e ndertimit dhe ndikimi në ambijentit përfshinë: Njohurit e përgjithshme mbi problemet të cilat do ti studiojn studentet gjatë studimeve në Fakultetin e Ndërtimtarisë, sic jane: njohurit themelore matematike, problemet në mekanike, materiale ndertimore, etj.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kursit(modulit): Të njihen studentet me mundesit per fitimin e njohurive mbi problemet e studimit në Fakultetin e ndërtimtarisë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Të fitoj njohuri mbi problemet themelore elementare në Matematikë, Njohja me Problemet në Mekanik, Materiale ndertimore dhe në lëndët profesionale. Të krijoj vizionin e prezentimit duke bërë prezentim nga pjesmarrja gjatë kryerjes së punimeve të ndryshme në teren.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjrate, dhe pune seminarike ne grupe
Metodat e vlerësimit:	Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 10% Provimi final 30% Total 100%
Literatura primare:	[1] Prof. Ass. Dr. Hajdar Sadiku Hyrje në Ndërtimtari (ligjërata), FNA, Prishtinë
Literatura shtesë:	[2] Prof. Dr. Fetah Jagxhiu, Mekanika I (ligjërata), FNA, Prishtinë [3] Prof asoc. Dr. Fisnik Kadiu, Teknologjia e materialeve të ndërtimit, FIN, Tiranë

Titulli i lëndës:	Gjuhë angleze
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Kursi i Gjuhës angleze në programin Inxhinieri e Ambientit ndërtohet mbi dy fundamente kryesore: (a) Anglishten për Qëllime Specifike që është dominantja e kursit dhe (b) Anglishten e Përgjithshme që ka shtrirje më të ngushtë brenda kursit. Studenti do t'i ekspozohet gjuhës kontekstuale të domenit të inxhinierinë mjedisore, ku rrjedhimisht do të jetë i aftë t'i konvertojë në anglisht strukturat dhe njohuritë të cilat apriori i përvetëson, gradualisht dhe paralelisht edhe në kurset e tjera profesionale. Veç kësaj, ai zhvillon edhe aftësinë e të shkruarit profesional relevant me domenin që studion, saqë do të jetë në gjendje të shkruajë emaile formale dhe joformale, rezume, letra motivuese, etj. Kursi është content-based, ku anglishtja specifike është gjuha që do të jehojë në klasë, sakaq fjalët, frazat, klauzolat, shprehjet dhe fjalitë që ai përdor, do të jenë në anglishte.
Qëllimet e lëndës:	Kursi në fjalë synon të maksimizojë performansën individuale dhe kolektive të studentëve, duke frymëzuar interesin e të nxënit dhe duke instaluar një ndjenjë të vetëbesimit në secilin prej tyre. Më tej, anglishtja në këtë program studimi synon t'i bëjë studentët kompetentë në përdorimin e gjuhës kontekstuale, veçanërisht në kontekstin e aftësive të të folurit dhe të shkruarit. Ndër objektivat tjera është që studentët të jenë në gjendje të përdorin literaturë në fushën e tyre të veçantë dhe të marrin pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare dhe diskutime profesionale, lirshëm, me një vetëbesim të shëndoshë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në fund të kursit, studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> • ta pasurojë vokabularin dhe diskursin me terminologji nga fusha e inxhinierisë së ambientit, kënaqshmërisht; • të flas me korrektësi, rrjedhshëm dhe të përdorë gjuhën kontekstuale pa ndonjë pengesë; • ta përdorë gjuhën angleze në një nivel më të avancuar për nevoja akademike dhe specifike; • të surfojë nëpër webfaqe relevante me fushën e tij specifike të studimit dhe të jetë në gjendje ta kuptojë dhe selektojë materialin që i nevojitet, dhe • të shkruajë emaile, kërkesa dhe letra motivuese në gjuhën angleze.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Që të materializohet ambicja e studentit për të penetruar në tregun global, ai duhet domosdo ta njohë gjuhën angleze me target të veçantë, anglishten e domenit të tij profesional. Prandaj, ky kurs është sa aktual, aq edhe i rëndësishëm pasi studentit ja hap dyert e një zhvillimi profesional, qoftë përmes pjesëmarrjes së tij në konferenca e simpoziume të ndryshme që pashmangshmërisht kontribuojnë në zhvillimin e tij profesional, qoftë përmes avancimit të tij karrierik në të ardhmen e tij të ndritshme.
Metodat e mësimdhënies:	Metodologjia jonë e mësimdhënies bazohet në stilet kryesorë të të nxënit, pra atij vizual, auditiv dhe kinestetik. Video, tryeza të rrumbullakëta, detyra dhe aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin e shkathtësive të studentëve do ta shoqërojnë metodologjinë tonë të mësimdhënies gjatë gjithë semestrit. Përveç kësaj, metodologjia jonë përfshin punimet në grup, seminarat dhe prezantimet e studentëve. Me pak fjalë, ndërveprimi do të mbizotërojë, dhe është studenti ai që do të jetë në qendër.
Metodat vlerësimit:	Vlerësimi arrihet përmes: Pjesëmarrjes fizike dhe participimit aktiv në ligjëratat: 10% Punimet Seminarik: 10% Testit afatmesëm: 20% Provimit final: 60% Pikët për notë: 92-100 10 81-91 9 70-80 8

	60-69	7
	50-59	6
Literatura primare:	Kolentay, Miloslav. English for Environmental Studies. Usti nad Labem, (2014).	
Literatura shesë:	Evans, Virginia et al. "Career Paths: Construction I Book 1", 2013: Express Publishing; Studentët do të pajisen me materiale të ndryshme që lidhen me domenin e tyre të veçantë si: worksheets, tekste, transkripte, etj.	

Titulli i lëndës:	Matematika II
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda ka të bëjë me njohuri nga matematika që kanë të bëjnë me lehtësimin e fitimit të njohurive nga lëndët tjera dhe zbatimin e njohurive në inxhinieri e ambientit. Paraqitet kuptimi i vargut numerik. Vetit e vargut aritmetik dhe gjeometrik dhe zbatimi i tyre në zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Paraqitja grafike e funksionet themelore elementare . Limiti dhe vazhdueshmëria e funksionit. Derivati i funksioneve elementare dhe derivatet e secilit funksion. Derivatet e rendeve të larta. Shqyrtimi dhe paraqitja grafike e funksioneve. Integrali i pacaktuar. Metodrat për njesimin e integralit të pacaktuar. Kuptimi integralit të caktuar. Zbatimi i integralit të caktuar në gjeometri.
Qëllimet e lëndës:	Njoftimi me njohuritë nga matematike të nevojshme për aplikimin në inxhinierinë e ambientit
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje që të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet e matematikës së lartë, me qëllim që ato njohuri ti ndihmojnë si aparat ndihmës në lëndët në të cilat është i domosdoshëm përdorimi aparatit matematikor.</p> <p>Studentët duhet të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ndërtojë vargje kur janë dhënë kufizat e përgjithshme të tyre - të zbatoi vetit e vargut aritmetik dhe gjeometrik në zgjidhjen e problemeve të ndryshme - të paraqes grafikisht funksionet themelore elementare - të zbatoi limitin e funksionit për të përcaktuar vazhdueshmërinë e funksionit - të nxjerr derivatin e funksioneve elementare dhe në bazë të vetive të derivatit të gjejë derivatin e secilit funksion, - duke u bazuar në derivatin e funksionit të shqyrtoi dhe të paraqes grafikisht funksionet - të gjejë integralin e pacaktuar për disa klasa të funksioneve - të zbatoi integralin e caktuar në zgjidhjen e disa problemeve nga gjeometria dhe mekanika
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Lënda ka rëndësi të veçantë sidomos në aplikimin në problemet e inxhinierisë së ambientit. Korrektësi në zgjidhjen e problemeve praktike. Aktualitet në zbatimin e teknologjive të informacionit.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimin duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë 20%; Vlerësimi i dytë 20%; Angazhimi në ushtrime 10% Vijimi i rregullt 10%; Provimi final 40%; Total 100%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fevzi Berisha-Abdullah Zejnullahu: Matematika- për arkitekturë , 1996, Prishtinë. 2. Fevzi Berisha: Përmbledhje detyrash të provimit nga matematika1,2, Prishtinë 2006. 3. Alexs Himonas , Alan Howard- Calculus Ideas and applications,203 USA 4. 4. Robert T. Smith , Roland B. Minton -CALCULLUS Single Variable, 2002 USA.
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ejup Hamiti – Matematika I, II. Elektro - Prishtinë 2. Isak Hoxha – Matematika I,I Ndërtimtari, Prishtinë 3. Ismet Dehiri – Matematika I,II Fakultet Teknik, Prishtinë 4. Përmbledhje të ndryshme të detyrave 5. Interneti

Titulli i lëndës:	Kimia e ambientit												
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda e kimisë së mjedisit është e nevojshëm për studentët e inxhinierisë mjedisore, sepse siguron bazat e nevojshme në kiminë mjedisore për të ndjekur një karrierë në inxhinierinë mjedisore. Ky është një kurs bazik i nivelit universitar për kimi mjedisore, i cili përfshinë hyrje në kiminë e mjedisit, kimia e atmosferës dhe ndotja e ajrit, kimia e hidrosferës, kimia e ujit dhe ndotja e ujit, kimia e biosferës, ndryshimet klimatike dhe energjia, ndotësit tipik dhe fati i tyre në mjedis, komponimet organike toksike dhe metalet, kimia e truallit, toka, sedimentet, dhe mbeturinat.												
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i kursit të kimisë së mjedisit është që të përgatisë studentët për të vijuar studimet në lëndët e afërta me fushën e kimisë mjedisore të rëndësishme për inxhinierinë mjedisore të cilat do të mbahen në semestrat në vijim. Ky paraqet një kurs hyrës në kiminë e mjedisit për inxhinierët e mjedisit, që nënkupton se paraprakisht kemi njohuri bazike për këtë lëndë. Ligjëratat kanë për qëllim zhvillimin e njohurive bazë për parimet themelore të kimisë së mjedisit që ndikojnë në proceset mjedisore të tilla si ujë dhe trajtimin e ujërave hedhurinë, kontrollin e ndotjes së ajrit dhe menaxhimin e mbeturinave.												
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në përfundimin të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Kuptojnë bazat e kimisë së mjedisit; ✓ Kuptojnë kiminë e tokës, ajrit dhe ujit; ✓ Kuptojnë mekanizmin me të cilin ndotësit mund të ndikojnë në cilësinë e tokës, ajrit dhe ujit; ✓ Kuptojnë lidhjet midis tokës, ajrit dhe ujit, si dhe lëvizjen e elementeve midis tyre; ✓ Kuptojnë burimet kryesore të energjisë dhe ndikimeve mjedisore të secilit prej tyre. 												
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratë, punë laboratorike, punë seminarike dhe individuale.												
Metodat e vlerësimit:	<table> <tr> <td>Vlerësimi i parë:</td> <td>25%</td> </tr> <tr> <td>Vlerësimi i dytë:</td> <td>30%</td> </tr> <tr> <td>Detyrat e shtëpisë dhe seminarët:</td> <td>5%</td> </tr> <tr> <td>Vijimi i rregullt:</td> <td>5%</td> </tr> <tr> <td>Provimi final:</td> <td>35%</td> </tr> <tr> <td>Total:</td> <td>100%</td> </tr> </table> <p>Vlerësimi final me note do të bëhet si vijon:</p> <p>51%- 60% = 6 61% -70% = 7 71% - 80% = 8 81% - 90% = 9 91%-100% =10</p>	Vlerësimi i parë:	25%	Vlerësimi i dytë:	30%	Detyrat e shtëpisë dhe seminarët:	5%	Vijimi i rregullt:	5%	Provimi final:	35%	Total:	100%
Vlerësimi i parë:	25%												
Vlerësimi i dytë:	30%												
Detyrat e shtëpisë dhe seminarët:	5%												
Vijimi i rregullt:	5%												
Provimi final:	35%												
Total:	100%												
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. A. Çullaj, Kimia e mjedisit, Tiranë, 2012. 2. Si literaturë e bazë e kursit do të jenë ligjëratat e autorizuara nga mësimdhënësi. 												
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Manahan, Environmental Chemistry, 5th Edition, 1991. 2. R. M. Harrison, An Introduction to Environmental Chemistry and Pollution, London, 1994. 3. O. Nill, Environmental Chemistry, See. Ed. London, 1993 												

Titulli i lëndës:	Mekanika I
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda: Mekanika I i përfshinë: Njohurit e përgjithshme mbi problemet e statikës së trupit të ngurt. Sistemin e forcave në rrafsh dhe në hapësir, Trupin dhe sistemin e trupave, mbajtësit Kapriat dhe menyrat e caktimit të forcave në shufra, Qendren e rëndesës si dhe zgjidhjen e mbajtësve linear në Hapësirë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kursit(modulit): Të njihen studentet me problemet e Mekanikes te cilat do të jenë bazë për lëndët profesionale gjat studimit në Fakultetin e Ndertimtarisë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Të fitoj njohuri mbi problemet themelore elementare në Matematikë, Njohja me Problemet në Mekanik, Kuptimin mbi forcën dhe ngarkesat, Kushtet e ekuilibrit të trupit, sistemit të trupave dhe mbajtësve kapriat si në rrafsh gjithashtu edhe në hapësirë, Caktimin e qendrës së rëndesës së trupave në terësi e në veqanti caktimin e qendrës së rëndesës për figurat plane.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerate, Ushtrime dhe Elaboratë
Metodat e vlerësimit:	Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 10% Provimi final 55% Total 100%
Literatura primare:	[1] Prof. Ass. Dr. Hajdar Sadiku Mekanika I (ligjërata në Sllajda), FNA, Prishtinë
Literatura shtesë:	[2] Prof. Dr. Fetah Jagxhiu, Mekanika I (ligjërata), FNA, Prishtinë [3] Prof. Dr. Fetah Jagxhiu, Mekanika I (Ushtrime), FNA, Prishtinë

Titulli i lëndës:	Gjeometri deskriptive
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Gjeometria Deskriptive teknike eshte shkenca e cila ka per detyre qe me metodat e saja te mundesoje nje paraqitje sa me te lehte dhe me te thjeshte te ndonje trupi tridimensional, duke u sherbyer me vizatimet dy dimensionale te cilat japin nje perftyrim sa me te qarte dhe te perpikte hapsinor te trupit te hartuar. Gjeometria Deskriptive perfaqeson ate dege te gjeometrise, ku format vellimore te sendeve si dhe ligjet perkatese gjeometrike te tyre studiohen me anen e projeksioneve. Afrimi i teorise dhe praktikes se Gjeometrise Deskriptive me praktiken inxhinierike behet me ndihmen e metodave grafike te paraqitjeve, duke ndihmuar ne rritjen e nivelit projektues dhe konstruktiv te inxhinierëve.
Qëllimet e lëndës:	Pregaditja bazike për prezantimin profesional dhe teknik të formave tredimensionale, përkatësisht projekteve arkitektonike si dhe zhvillimin e aftësive për kuptimin e hapësirës tredimensionale dhe të menduarit hapësinor në kontekst të artikulimit të nocionove themelore në profesionin e arkitekturës.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Lënda bënë pjesë në grupin e lëndëve pregaditore dhe mundëson përfitimin e njohurive bazike për studime të mëtejme në lëmin e Arkitekturës dhe të Planifikimit hapësinor.
Metodat e mësimdhënies:	LIGJERATE + USHTRIME
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i pare 15% Vlerësimi i dytë 20% Vlerësimi i ushtrimeve dhe maketave 10 % Provimi final 55% Total 100%
Literatura primare:	Flamur DOLI, Gjeometria Deskriptive, Prishtinë, 1990
Literatura shtesë:	B. QURÇIQ, Vizatim teknik me Gjeometri deskriptive, Prishtinë 1983, Si dhe e gjithë literatura tjetër nga kjo lëmi

Titulli i lëndës:	Hyrje në informatikë dhe programim
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë përmban materialin mësimor për mësimin e bazave të njohurive në informatikë, siç janë krijimi i dokumenteve, përpunimi i tabelave dhe realizmi i prezantimeve. Për më shumë, kjo lëndë shpjegon sintaksën e komandave bazike të një gjuhë programuese, si dhe algoritmet e për zgjedhjen e problemeve të ndryshme të nivelit shkollorë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është që të pajisë studentin me njohuritë bazike në informatikë, si dhe me teknikat e bazë të programimit. Thëks i veçantë i kushtohet përpilimit të algoritmeve për zgjedhjen e problemeve, si dhe shkuarjes së programeve përmes gjuhës programuese Python.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas mbarimit të kësaj lënde, studenti duhet: <ul style="list-style-type: none"> • Të jetë në gjendje të përpunoj dokumente përmes softuerëve për editimin e dokumenteve, • Të jetë në gjendje të përpunoj tabela përmes softuerëve për editimin e tabelave, • Të jetë në gjendje të përpunoj prezantime elektronike përmes softuerëve për editimin e prezantimeve, • Të kuptoj teorinë prapa programimit, • Të jetë në gjendje të kuptoj dhe përdorë komandat bazë të gjuhës programuese Python, • Të jetë në gjendje të përpiloj algoritmin/diagramin e rrjedhës për zgjedhjen e problemeve të ndryshme të nivelit shkollor, • Të njohë teorinë prapa programimit të orientuar në objekte
Metodat e mësimdhënies:	Pjesa më e madhe e ligjëratave mbahet në formën klasike, të cilat janë të mbështetura me softuer përkatës për krijimin dhe implementimin e programeve për punë laboratorike. Analiza e programeve kompjuterike të ndryshme nga materiali mësimor dhe diskutime me studentë.
Metodat e vlerësimit:	Kolokviumi 1 (40%), Kolokviumi 2 (40%), Aktiviteti në klasë (20)%
Literatura primare:	1. Introduction to Computers, Peter Norton, 6th International Edition (McGraw-Hill) 2. Fundamentals of Python Programming, Richard L. Halterman, 2018
Literatura shtesë:	1. Algorimet dhe Programimi, Ivana Ognjanovic, Ramo Shendel, (Teksti mësimor për vitin e tretë ose të katërt të gjimnazit) 2. Algorimet dhe Programimi, Ivana Ognjanovic, Ramo Shendel, (Përmbledhje detyrash për vitin e tretë ose të katërt të gjimnazit)

Titulli i lëndës:	Termodinamika e inxhinierisë
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda Termodinamike e Inxhinierisë studion Ligjin I të termodinamikës dhe Ligjin II të termodinamikës dhe merret me mënyrën e përcaktimit të vetive të substancave homogjene. Po ashtu materie e lëndës është edhe përcaktimi i bilancit të masës, energjisë dhe entropisë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme inxhinierie.
Qëllimet e lëndës:	Theksi i lëndës do të vihet në zhvillimin e aftësisë së studentit për: <ol style="list-style-type: none"> 1. Aplikimin e parimit të konservimit të masës dhe të energjisë për vlerësimin e performancës së sistemeve të thjeshta inxhinierie 2. Analizimin e vetive termodinamike të substancave të thjeshta homogjene 3. Analizimin e proceseve dhe cikleve duke shfrytëzuar Ligjin II të termodinamikës për përcaktimin e efijencës maksimale 4. Vlerësimin e vetive të ajrit të lagësht 5. Analizimin e proceseve të kondicionimit të ajrit 6. Analizimin e ligjshmërive të transmetimit të nxehtësisë për zgjidhjen e problemeve të thjeshta të shndërrimit të energjisë
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: <ol style="list-style-type: none"> 1. Të njoh lëndën 2. Të merr asistencë nga kursi për hartimin e elaborateve (projekte ideore) dhe projekteve profesionale
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Termodinamike e inxhinierisë si lëndë bazike përherë do të jetë e rëndësishme dhe asnjëherë nuk do ta humb aktualitetin
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime gjatë orëve të mësimin duke përdorë materiale të ndryshme (diagrama, tabela), detyrë seminarike individuale.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit 80%; Detyrat individuale të kryera në klasë 60%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 60%; Vlerësimi nga testet 80%; Provimi final 80%.)
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjëratat e përgatitur nga Prof. Dr. Xhemajl Fejzullahu 2. Termodinamika dhe hidraulika, Krasniqi, F. Dhe Fejzullahu, Xh., Enti i botimeve, Prishtinë 1996
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Windisch, H. THermodynamik, Oeldenburg Verlag, Munchen,1008 2. Çengel, Y.; Boles, D.: Thermodynamics- an Engineering Approach, McGraw Hill, 2011

Titulli i lëndës:	Mikrobiologjia ambientale
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë ka të bëjë me ligjshmëritë dhe konceptet e ndërveprimit ndërmjet mikroorganizmave dhe mjedisit, ndikimin e faktorëve ekologjikë në mikroorganizma, rolin e mikroorganizmave në qarkullimin e materies dhe energjisë, mënyrat e marrëdhënieve jetësore të mikroorganizmave ndërmjetveti dhe me mjedisin, si dhe aftësitë e mikroorganizmave për të jetuar në kushte ekstreme.
Qëllimi i lëndës:	Programi mësimor i lëndës Mikrobiologji mjedisore, ka për qëllim të zhvillojë njohuritë lidhur me marrëdhëniet midis mikroorganizmave dhe mjedisit, të mikroorganizmave ndërmjetveti dhe me organizmat tjerë, rolin e mikroorganizmave në qarkullimin e materies në mjedis, si dhe aftësitë e mikroorganizmave për të jetuar në mjedise me kushte ekstreme.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë mënyrat e ndërveprimit midis mikroorganizmave dhe mjedisit. • Të definojnë rolin e faktorëve ekologjikë në jetën e mikroorganizmave. • Të kuptojnë dhe përshkruajnë mënyrat dhe rolin e mikroorganizmave në qarkullimin, biogjeokimik të C, N, S, P etj. • Të kuptojnë mënyrat e bashkëjetesës së mikroorganizmave: shembujt e simbiozës, varësinë e ndërsjellë, kushtet e mjedisit uxor dhe atij tokësor. • Të kuptojnë aftësitë e mikroorganizmave për të jetuar në mjedise me kushte ekstreme.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjeratë, mesim interaktiv me studentet ne grupe, diskutim, debate, ilustrimet, vizatimet, slajdet, modelet etj
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera:10% Vijueshmëria e rregullt:5% Provimi final: 30% Totali:100%
Literatura primare:	1. Prescott, L. M. HARLEY., P. J. and D. A. KLEIN (1999): MICROBIOLOGY, 4 th edition, McGraw-Hill, faqet 831- 906. 2. Tortora, Funke, Case (1986): Microbiology an Introduction. Faqe: 700 - 726
Literatura shtesë:	1. Muje Plakolli: Mikrobiologjia e pergjithshme, botoi ETMM, Prishtine, 2001. 2. Alexander–Strete–Niles: Lab Exercises in Organismal and Molecular Microbiology., The McGraw–Hill Companies, 2003 3. MYUNG-BO KIM (2008): PROGRESS IN ENVIRONMENTAL MICROBIOLOGY., by Nova Science Publishers, Inc. New York 4. I.L. Pepper and C.P. Gerba (2004): Environmental Microbiology A Laboratory Manual., Elsevier Academic Press 30 Corporate Drive, Suite 400, Burlington, MA 01803, USA 525 B Street, Suite 1900, San Diego, California 92101-4495, USA 84 Theobald's Road, London WC1X 8RR, UK

Titulli i lëndës:	Materialet e ndërtimit
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Njohurite bazike të aplikimit të materialeve në etapa të ndryshme kohore në Inxhinierinë e Ndërtimit dhe fushat e ngjashme. Vetite e materialeve të ndërtimit: Vetite fizike; Mekanike; kimike dhe vetite fiziko mekanike. Guri si material i ndërtimit dhe karakteristikat e aplikimit në inxhinieri të ndërtimit. Agregati si produkt i gurit; karakteristikat dhe vlerësimi i vetive të agregatit. Materialet argjilore, karakteristikat dhe llojet e materialeve argjilore. Vlerësimi i ekzaminimit të vetive të materialeve argjilore bazuar në Standardet EN. Qelqi si material në ndërtimtarë, karakteristikat dhe aplikimi. Lëndet lidhëse prejardhje inorganike: gelqerja; allcia dhe cimentoja Betoni dhe përdorimi i betonit . Llojet e llacnave dhe karakteristikat. Celiku, metalet e lehta, karakteristikat dhe krahasueshmëria me materialet tjera, Druri, druri i lameluar dhe karakteristikat .Materialet termoizoluese dhe hidroizoluese.Materialet e Reciklueshme dhe përdorimi i tyre
Qëllimet e lëndës:	Te aftësojë studentet në njohuritë për materialet e ndërtimit; vetite e tyre dhe ekzaminimet e vetive me qëllim të përdorimit në fushën e Inxhinierisë së ambientit në pozicione të ndryshme
Rezultatet e pritshme të nxënies:	-te njohë materialet e spjeguar, që janë përdorur me kohën -te përcaktojë karakteristikat fizike, mekanike, kimike dhe fiziko-mekanike të materialeve -te përdorë materialet adekuate për pozicionet dhe objektet përkatëse -bazuar në të arriturat dhe zhvillimin teknologjik të mund të bëjë ndonjë avansim eventual
Metodat e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligjëratat me prezantim dhe demonstrime praktike të materialeve të ndërtimit - Ushtrimet numerike dhe laboratorike - Seminar semestral me detyra konkrete. - Diskutime gjatë ligjëratave. - Ushtrime në grupe.
Metodat e vlerësimit:	Gjatë semestrit mbahen dy kolokiume me këto vlerësime: <ul style="list-style-type: none"> - kolokiumi i parë 50 %, - kolokiumi i dytë 50 % Mesatarja nga dy kolokiumet zëbërthehet në notë. Derisa provimi i lëndës <ul style="list-style-type: none"> - me shkrim 50% - Me gojë 50%
Literatura primare:	1/ N.Kabashi- Materialet Ndërtimore IA (ligjerata) 2/ Prof asoc. Fisnik Kadiu: Teknologjia e Materialeve të Ndërtimit
Literatura shtesë:	1/ Randall McMullan: Environmental Science in Building 2/ Neil Jackson and Ravindra K. Dhir: Civil Engineering Materials 4/ K.van Breugel: Simulation of hydration and formation of structure in hardening cement-based materials 5/ Schaffler/Bruz/Schelling: Bausstoffkunde 6/ A.M.Neville: Properties of Concrete

Titulli i lëndës:	Gjeologjia inxhinierike
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda do të zhvillohet në tre pjesë: Në pjesën e parë do të përfshihen parimet kryesore të gjeologjisë fizike si: struktura e tokës, vullkanizmi dhe proceset tjera të krijimit të kurorave malore, tektonika e pllakave, proceset e erozionit, formimi, klasifikimi dhe vetitë e mineraleve dhe shkëmbinjve. Pjesa e dytë përfshinë aplikimin e njohurive gjeologjike në problemet inxhinierike gjatë ndërtimit siç janë: rreshqitjet, termetet, subsidencat (zhytjet), ndërtimet e objekteve si: ndërtesa, rrugë, ura, tunele, etj Pjesa e tretë përfshinë klasifikimin gjeologo – inxhinierik të shkëmbinjve dhe dherave
Qëllimet e lëndës:	Që studentët të kenë qasje inxhinierike në: përcaktimin e kushteve gjeologjike gjatë ndërtimit të objekteve (ndërtesa, rrugë, ura, tunele, etj), përdorimin e hapësirës (kushtet natyrore të planifikimit hapësinor, studimin e vlerësimeve të ndikimit në mjedis), rehabilitimin e rrëshqitjeve të tokës dhe pasojave tjera nga proceset natyrore ekzo - gjenetike si dhe pasojave nga aktivitetet e njeriut. Aftësimi i studentëve për të mbledhur dhe shfrytëzuar të dhënat gjeologo - inxhinierike numerike dhe jonumerike si pjesë e modeleve gjeologo- inxhinierike të cilat si inpute shfrytëzohen në mekanikën e trolit dhe shkëmbinjve
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me të përfunduar të lëndës, studentët do të jenë të aftë të: <ul style="list-style-type: none"> • Aplikojnë njohuritë gjeologjike në ndërtimtari • Kuptojnë strukturat e brendshme të ndërtimit të Tokës • Dallojnë tipet e shkëmbinjve dhe dherave - karakteristikat e tyre duke i marrë në konsideratë gjatë ndërtimit të: digave, tuneleve, urave, objekteve ndërtimore, autostradave, aeroporteve etj • Kuptojnë proceset gjeologjike sipërfaqësore, si ndikojnë ato në studimet inxhinierike • Kuptojnë proceset e brendshme gjeologjike (p.sh. shkarjet, termetet, vullkanet) dhe ndikimin e tyre në studimet inxhinierike • Aftësohen për leximin e raporteve gjeologjike
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimt duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është mbi 50%. Vijueshmëria e studentit 5%; Detyrat individuale të kryera në klasë 10%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 10%; Vlerësimi nga testet 50%; Provimi final 25%.)
Literatura primare:	1. Islam Fejza – Ligjerata të autorizuara 2. Nikolla Konomi., 2006. Gjeologjia Inxhinierike, Tekst Universitar. Tiranë. Shqipëri
Literatura shtesë:	1. Blyth F.G.H. and de Freitas M.H., Geology for Engineers, Edward Arnold, London, 2010. 2. Bell .F.G.. “Fundamentals of Engineering Geology”, B.S. Publications. Hyderabad 2011.

Titulli i lëndës:	Meteorologjia
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Kjo lende ju mundëson studenteve përvetësimin e njohurive teorike dhe praktike për elementet dhe dukurit meteorologjike të monitoruara sipas metodave të bashkohore me teknologjinë satelitore dhe ato digjitale në shkallë vendi dhe rajoni. Monitorimi i resurseve natyrore dhe cilësive të ajrit në shkallë vendi. Aplikimi i teknologjive të arritura teknike shkencore sipas disiplinave të adekuata të lëmit të meteorologjisë, klimatologjisë dhe agrometeorologjisë. Komponentet meteorologjike dhe ato fizike të mjedisit. Ndikimet integruuese të parametrave mjedisore në ndryshimet klimatike dhe pasojat e këtyre ndryshimeve në flora dhe faunë. Aplikimi i modulimeve matematikore në saktësimin e motit dhe fatkeqësive natyrore, vërshimeve dhe thatësirave
Qëllimet e lëndës:	Kuptimi i fiziko-biologjike, meteorologjik, klimatologjik dhe agrometeorologjik i ndërveprimeve komplekse brenda sistemit kulturë-tokë-atmosferë dhe komponentët e tyre kryesore.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Te jete i pavarur në punën e tij për analizimin e elementeve dhe dukurive meteorologjike në monitorimin, analizimin si dhe parashikimin e motit dhe fatkeqësive natyrore në shkallë vendi e me gjere si dhe faktorve meteorologjike, klimatologjik dhe atyre agrometeorologjik. ➤ Te njoh elementet dhe dukurit meteorologjike, klimatologjike dhe ato agrometeorologjike me qëllim të avansimit të metodave teorike dhe atyre praktike në parandalimin e rreziqeve të cilat vijnë nga proceset atmosferike në shkallë rajoni dhe vendi. ➤ Te fitojnë njohuri themelore në lidhje me aplikimin e metodave bashkohore në saktësimin e rreziqeve të cilat vijnë nga proceset atmosferike në shkallë rajoni dhe vendi me qëllim që organet relevante shtetërore të marrin masat mbrojtëse nga këto rreziqe.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerat, ushrtime, punë praktikore grupe, seminare, konsultime, casje interactive, prezantime të studenteve etj
Metodat e vlerësimit:	Përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermediar e përcaktonë vlerësimin definitiv. Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%
Literatura primare:	1. Mandili, T, Tili, J. Meteorologjia Bujqësore për fakultetin Agronomisë pjesa e I dhe e II 1980 Tiranë 2. Tahirsylaj, S: (Fizika me Agrometeorologji dispencë, 2006) 3. Zorba, P (Klimatogjeografia- Tiranë, 2006) 4. Tahirsylaj, S: (Praktikum i meteorologjisë, 2005) 5. Tahirsylaj, S: (Ushtrime numerike në meteorologji dhe agrometeorologji dispencë, 2005) 6. Mandili, T (Klima dhe kulturat bujqësore, 1975 Tiranë) 7. Milosavlevic, M (Meteorologjia, 1980 Prishtinë përkthim në <i>gjuhën shqipe</i>)
Literatura shtesë:	1. ASHAT (Klima e Shqipërisë, 1978 Tiranë) WMO (OBM) Atlasi i reeve pjesa e I, II në CD

Titulli i lëndës:	Sigurimi i shëndetit
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Shëndeti dhe sëmundja- përkufizimet sipas OBSH. Ndikimi i ambientit në shëndet. Njohurite themelore për faktoret mjedisor, ndikimet pozitive dhe negative në shëndet. Vlerësimi i riskut mjedisor, sëmundjet e shkaktuara nga faktorët mjedisor. Shëndeti në punë
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim ofrimin e njohurive bazike nga shëndeti mjedisor dhe sigurimin e masave mbrojtëse për shëndetin e njeriut. ,zbulimi i hereshëm i ndikimit negativ të faktoreve mjedisor .Zbatimi i njohurive nga mesimet në kushtet e praktikës profesionale të gjetura në situatat specifike , masat mbrojtëse në punë dhe komunitet
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me të përfunduar të lëndës, studentët do të jenë të aftë të: <ul style="list-style-type: none"> • Te dalloj efektin pozitiv nga ai negativ i mjedisit. • Të vetëdijesohen për rëndësinë e shëndetit si dhe si ta ruajme atë. • Masat mbrojtëse të shëndetit në mjedisin punës
Metodat e mësimdhënies:	Interaktive, scenario, studim rasti dhe situatat
Metodat e vlerësimit:	Seminaret, prezantimet; 10% Vlerësimi 1: 20% Provimi final ; 70% Vijimi i rregullt – vendimtar në rastet dilematike
Literatura primare:	1. Ekologjia Humane dhe shëndeti publik; Pollozhani, Krasniqi, Kendrovski 2. Medicinska Ekologjia; Valic F.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Public Health and Environmental Epidemiology; J. Last • Environmental Health; Oxford textbook of Public Health

Titulli i lëndës:	Ekonomia ne inxhinieri								
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Shumica e projekteve inxhinierike do të duhet të plotësojnë tri teste kryesore për t'u ndërtuar: a) projekti duhet të jetë teknikisht i zbatueshëm; b) në një ekonomi të tregut të lirë projekti duhet të bëjë investime ekonomikisht atraktive, c) të jetë e ligjshme për t'u kompletuar (një pjesë e madhe e kësaj ka të bëjë me shëndetin e mjedisit). Ky kurs do të sigurojë dhe ofroje njohuri për studentët në lidhje me keto çështje kryesore.								
Qëllimet e lëndës:	Megjithëse në këtë shkallë studentët nuk do të bëhen ekspertë në biznes dhe financa, ata do të dinë se si të vlerësojnë nëse të ardhurat nga projektet do të kënaqin investorët në mënyrë të mjaftueshme për të marrë kapital për të ndërtuar projektin. Kjo është lenda ku ata do të mësojnë se si të vlerësojnë nëse potenciali i të ardhurave të një projekti do ta bëjë atë llojin e projektit në të cilin njerëzit do të investojnë. Krahas mësimit të tyre si të vlerësojnë qëndrueshmërinë ekonomike të projekteve inxhinierike, kjo lende gjithashtu ka qëllimin për t'u treguar se si mund të përdoren teknikat e vendimmarrjes së investimeve në inxhinieri, për t'i ndihmuar ata të rrisin pasurinë e tyre personale dhe të shmangin gabimet financiare.								
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët, në fund të kursit do të jenë në gjendje të kuptojnë: <ol style="list-style-type: none"> 1.Pse ka një vlerë kohore të parave, 2.Katër Komponentet e Normave të Interesit, 3.Përlogaritja e vlerës së ardhshme të interesit të një shume aktuale, 4.Zbritja e fluksit të parave në një pikë të vetme në kohë, 5.Vlera aktuale e parave në të ardhmen 6. Konvertimi i vlerave aktuale në anuitete, 								
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, Punim seminarik, dhe diskutim i rasteve.								
Metodat e vlerësimit:	<table> <tr> <td>Vlerësimet gjatë orëve:</td> <td>40%</td> </tr> <tr> <td>Seminari</td> <td>50%</td> </tr> <tr> <td>Vijimi i rregullt:</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>100%</td> </tr> </table>	Vlerësimet gjatë orëve:	40%	Seminari	50%	Vijimi i rregullt:	10%	Total	100%
Vlerësimet gjatë orëve:	40%								
Seminari	50%								
Vijimi i rregullt:	10%								
Total	100%								
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Donald G Newnan: "Engineering Economic Analyses" 2. Leland T Blank: "Engineering Economy" 								
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 3. Raftery, John (1991): "Principles of Building Economics", Blackwell, Oxford. 								

Titulli i lëndës:	Probabiliteti dhe statistika		
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda ka të bëjë me njohuri nga statistika dhe teoria e probabilitetit që kanë të bëjnë me lehtësimin e fitimit të njohurive nga lëndët tjera dhe zbatimin e njohurive në inxhinieri e ambientit. Paraqiten kuptimet mbi algjibrën e ngjarjeve. Përkufizohet probabiliteti në mënyrë klasike, gjeometrike dhe aksiomatike. Vërtetohen formulat themelore të probabilitetit, formula e probabilitetit të plotë dhe formula e Bajesit. Përkufizohen ligjet e shpërndarjes së gjasave. Paraqiten parametrat për ndryshoren e rastit. Paraqiten disa shpërndarje më të rëndësishme që zbatohen në inxhinierin e ambientit. Përkufizohen llojet e konvergjencave. Elementet e statistikës matematike. Shqyrtohet një analizë statistikore me anë të mesatareve algjebrike dhe pozicionale duke zbatuar treguesit absolut dhe relativ të variacionit. Praktikohen disa programe të njohura statistikore për ambientin.		
Qëllimet e lëndës:	Njoftimi me njohuritë nga statistikës matematike dhe të teorisë së probabilitetit të nevojshme për aplikimin në konceptet matematike në lëmin e inxhinierisë së ambientit.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje që të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet e statistikës matematike, me qëllim që ato njohuri të ndihmojnë si aparat ndihmës në lëndët tjera ku aplikohet aparatura e statistikës matematikore si dhe pastaj ti zbatoi sidomos në problemet konkrete që kanë të bëjnë nga lëmi e inxhinierisë së gjeodezisë dhe matjeve gjeodezike.</p> <p>Studentët duhet të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kuptojnë konceptin ngjarje dhe bashkësi, llojet e ngjarjeve dhe veprimet me ngjarje - të zbatoi elementet e kombinatorikës në teorinë e statistikës dhe në njësimin e ngjarjeve njëjloj të mundshme - të përkufizoi kuptimin klasik, gjeometrik dhe aksiomatik të gjasës - të paraqes ndryshoret e rastit të vazhdueshme dhe diskrete - të zbatoi disa shpërndarje teorike të gjasave - në metodën e hulumtimit të zbatoi njohurit nga statistika matematike, metodën e analizës dhe statistikën përshkruese. 		
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Lënda ka rëndësi të veçantë sidomos në aplikimin në problemet e inxhinierisë së ambientit. Aktualitet në zbatimin e teknologjive të informacionit.		
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimi duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë	20%	
	Vlerësimi i dytë	20%	
	Angazhimi në ushtrime	10%	
	Vijimi i rregullt	10%	
	Provimi final	40%	
			Total 100%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. A.Zejnullahu ,F.Berisha - Matematika III,1997,Prishtinë 2. Sh. Leka – Teoria e probabilitetit dhe statistika matematike,1998,Tiranë. 3. Marilyn K. Pelosi, Theresa M. Sandifer- Elementary statistics, 2003, USA 4. William Navidi- Statistics for Engineers and Scientists, 2006 USA 		
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ll.Puka – Probabilitetit ,1998,Tiranë. 2. Bushati – Ushtrime të zgjidhura të probabilitetit dhe statistikës,1999,Tiranë. 3. W.Feller –An introduction to probability theory and its application,1970,New York 4. Elzar – Matematika statistika ,1968 ,Sarajevë 		

Titulli i lëndës:	Mekanika e fluideve
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda Mekanike e fluideve përfshinë: Fluidet dhe ndarja e tyre. Karakteristikat e fluideve. Hidrostatika, Ligji i Paskalit dhe ekuacioni i hidrostatikes. Forca e shtypjes hidrostatike në sipërfaqe të rrafsheta dhe rrethore, intensiteti, drejtimi i saj. Parimet e kinematikes së fluideve. Përshkrimi i rrjedhës së fluidve sipas Langrange-it dhe Euler-it. Klasifikimi i rrjedhjes, ekuacioni i kontinuitetit. Matjet e shpejtesise. Dinamika e fluideve. Ekuacionet e energjise. Ekuacioni i Bernoullit dhe Eulerit. Aplikimi i ekuacionit të Bernoullit. Rezistencat që paraqiten gjatë rrjedhjes dhe llogaritë e humbjeve të energjise. Rrjedhja laminare dhe turbulente, formula e Darcy-Weisbachut dhe diagrami i Moody-it. Rrjedhja nëpër gypa dhe kanale të hapura.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kursit (modulit): Kuptimi dhe aplikimi i ekuacioneve bazike për zgjedhjen e problemeve në fushën e Mekanikes së Fluideve. Kuptimi i konceptit të viskozitetit dhe rëndësia e tij në rrjedhjet reale. Mesimi i shfrytëzimit të ekuacioneve të kombinuara me të dhëna eksperimentale për të përcaktuar humbjet në sistemet rrjedhëse.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshem të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: <ol style="list-style-type: none"> 1. Të definojë termet bazike dhe ligjet në fushën e karakteristikave të fluideve, statiken, kinematiken dhe dinamikën e fluideve. 2. Të aplikoj parimet fundamentale dhe ligjet e mekanikes së fluideve, 3. Të jetë i aftë të aplikojë ekuacionin e Bernoullit për të zgjedhur probleme në mekanikën e fluideve, 4. Të aplikoj ekuacionin e Energjise në zgjedhjen e problemeve praktike.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata frontale, ex cathedra, ushtrime numerike, punë seminarike në grupe.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 45% Vlerësimi i dytë: 45% Elaboratet: 10% Provimi final
Literatura primare:	1. Kusari, L. Shenime nga Mekanike e fluideve
Literatura shtesë:	2. Potter, M., Wiggert, D., Mechanics of Fluids 3. Mott, R., Applied Fluid Mechanics

Titulli i lëndës:	Hidrologjia
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lenda e Hidrologjisë përfshinë: Bilanci ujor dhe madhësia e tij, Hidrometria dhe proceset e matjeve meteorologjike, Metodatat dhe pajisjet për matjen e nivelit dhe prurjet e ujit, Matja e prurjeve të ngurta, Vlerësimi i parë intermediar, Njohuritë e përgjithshme për lumenjtë, Kushtet klimatike që ndikojnë në regjimin hidrologjik të lumenjve, Përdorimi i teorisë së probabilitetit dhe statistikës matematike në hidrologji, Vargu statistikor dhe shpërndarja e rastisjeve, Histogrami i shpërndarjes së rastisjeve, etj.
Metodat e mësimdhënies:	Metoda e të mësuarit të lëndës HIDROLOGJIA konsiston në mbajtje të ligjëratave, daljes në terren dhe përgatitjes së seminareve.
Qëllimet e lëndës:	Bazat e hidrologjisë: reshjet, avullimi, hidrometria, lidhja korrelative, parashikimet hidrologjike. Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: 1. t'i njeh pajisjet për matjet në hidrologji, 2. të zgjedhë pajisjet dhe proceset për matje 3. të zgjedhë metodat për vlerësimin e shënimeve, 4. të përpunojë shënimet hidrologjike për probleme të caktuara.
Literatura primare:	1. Dr. Naim Hasani: Ligjëratat dhe ushtrimet e Hidrologjisë 2. B. Shehu dhe K. Karanxha: Hidrologjia Inxhinierike I (Shtëpia botuese e librit Universitar Tirane) 3. Manik: Hidrologie und Wasserwirtschaft
Literatura shtesë:	1. Prof. Dr. M. Disse: Hydrologie und Wasserwirtschaft I, E gjithë literatura tjetër nga kjo lëmi

Titulli i lëndës:	Mekanika e dherave
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda: Mekanika e dherave përfshinë: Hulumtimet e dheut nga sipërfaqja e terrenit, Provat në terren “in situ”. Fazat e materialit të dherave, Poroziteti I dherave, pasha specifike dhe vëllimore, lagështia dhe konsistenca e dherave, Ngjeshja e dherave, shqyrtimet laboratorike dhe në terren. Ujëpërshkueshmëria e dherave, provat laboratorike të përcaktimit të koeficientit të filtrimit të dherave në laborator dhe në terren. Rezistenca e dherave në rëshqitje. Shafitja e dherave. Shpërndarja e sforcimeve në tokë, ekuacionet e Boussinesqut, metoda e Steinbrennerit dhe Newmarkut. Konsolidimi i dherave. Stabiliteti i pjerrësirave. Presionet e dheut në muret mbrojtëse. Aftësia mbajtëse e dherave.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kursit(modulit): Të njihen e parimet bazë të Mekanikës së dherave të cilët më vonë do t’i përdorin për analizën e stabilitetit të konstruksioneve të ndryshme në inxhinierinë e ndërtimit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me përfundimin e ligjëratave të kësaj lënde studentët do të kenë kuptuar parimet fundamentale të mekanikës së dherave, do të jenë në gjendje të kryejnë provat të shqyrtimeve laboratorike dhe provave në terren, interpretimin e të dhënave të shqyrtimeve laboratorike dhe shqyrtimeve në terren. Të zotëroj aplikimin e veçurive fiziko-mekanike dhe inxhinierike të dherave në praktikën inxhinierike, të njohin të gjitha metodat e llogaritjes gjatë analizës së stabilitetit, të përpilojnë programin e shqyrtimeve gjeomekanike për “Elaboratin Gjeomekanik” të terrenit të objektit përkatës ndërtimor.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerate, Ushtrime dhe Elaboratë
Metodat e vlerësimit:	Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 10% Provimi final 55% Total 100%
Literatura primare:	[1] Dr.sc. Qani V. KADIRI, Ligjeratat e autorizuara nga Mekanika e Dherave, FNA, Prishtinë [2] Dr. Sc. Fikret Ahmedi, Libri Mekanika e dherave, FNA, Prishtinë [3] Braja Das, Principle of Geotechnical Engineering, USA
Literatura shtesë:	[4] Prof.Dr. Ervin Nonweiler, Mehanika tla i temeljenje gradevina, Zagreb [5] V.N.S Murthy, Geotechnical Engineering, USA

Titulli i lëndës:	Menaxhimi i ujit urban
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Mundësitë e menaxhimit të ujit në një vendbanim prezentohen përmes kësaj lënde. Temat që shtjellohen në këtë lëndë janë: Hyrje në menaxhimin e ujërave urbane; Karakteristikat e ujit dhe kualiteti i ujit; Kërkesat për ujë të pijes, prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijes; Ujërat e ndotura dhe ndotësit; Kanalizimi urban dhe trajtimi i ujërave të ndotura; Planifikimi i infrastrukturës ujore urbane.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim të ofrojë njohuri të përgjithshme mbi furnizimin me ujë, kanalizimin dhe trajtimin e ujërave, si tema mbi menaxhimin e resurseve ujore urbane. Thelbi do të vihet në zhvillimin e aftësisë së studentit për të kuptuar se çfarë mund të jenë dhe për çfarë shërbejnë sistemet furnizuese dhe ato të kanalizimeve, të cilët (studentët) duke i krahasuar sistemet, do të dijnë të përzgjedhin sistemin e përshtatshëm menaxhues të ujërave urbane.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me të përfunduar të lëndës, studentët do të jenë të aftë të: <ul style="list-style-type: none"> • vlersëojnë kualitetin e ujit në bazë të përmbajtësve në të • të përcaktojnë sasinë e ujit për shfrytëzuesit dhe shpenzuesit e ujit dhe • planifikojnë infrastrukturën furnizuese dhe mbledhëse të ujit urban.
Rëndësia dhe aktualiteti i lëndës	Plotësimi i nevojave për shfrytëzim të ujit për qëllime të ndryshme, shfrytëzimi racional i ujit, mbrojtja e ambientit duke i mbledhur ujërat e perdorura dhe ruajtja e resurseve ujore duke i shfrytëzuar ato në mënyrë të qëndrueshme.
Metodat e mësimdhënies:	Lënda zhvillohet përmes ligjëratave të rregullta dhe ushtrimeve numerike të zgjedhura në klasë (në grup prej 2-3 studentëve) dhe individualisht në shtëpi.
Metodat e vlerësimit:	Parakusht - Lënda: Mekanika e fluideve Vlerësimi bëhet nga 0-100 % Vlerësimi i parë: 35% Vlerësimi i dytë 35% Detyrat e shtepise 30% Vijimi i rregullt – vendimtar në rastet kufitare Provimi final
Literatura primare:	1. Ligëjrata të përgatitura nga Prof. asoc. F. Ahmedi
Literatura shtesë:	1. Jahic. M., <i>Urbani Vodovodni Sistemi</i> . Sarajevo, 1988. 2. Metcalf & Eddy, Inc. <i>Wastewater Engineering: Treatment and Reuse</i> . 4th ed, McGraw Hill, Inc., New York, 2003 3. Daka. S., <i>Furnizimi me ujë</i> , 2007 4. Butler. D., Davies. J. <i>Urban Drainage</i> , 2000

Titulli i lëndës:	Projektimi i deponive
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda: Projektimi i deponive përfshinë problematikën e mbeturinave të ngurta, planifikimi i deponisë, teknologjinë e deponimit, efektet përcjellëse në deponitë dhe karakteristikat e tyre, Projektimin dhe realizimi i deponive, Pasijet në deponitë, Vetitë gjeoteknike të deponisë së mbetjeve- si objekt gjeoteknik, Sanimi i deponive, Paisjet në deponitë, Udhëheqja e deponisë dhe kontrolli i punës, Mbrojtja e ujrave në deponitë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kursit(modulit): Të njihen me parimet bazë të faktorëve ndikues në deponi, të cilat shërbejnë për projektimin dhe sanimin e deponive.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me përfundimin e ligjëratave të kësaj lënde studentët do të kenë kuptuar parimet bazë mbi projektimin e deponive, do të jenë në gjendje të kryejnë provavat e shqyrtimeve në terren të materialeve të deponuara, mënyrën e realizimit të izolimit të bazës nga filtratet që rrjedhin nga trupi i deponisë, ajrosjen e deponive, planifikimin dhe teknologjinë e deponimit të materialeve të ngurta, llojin dhe mënyrën e përdorimit të mekanizimit në deponi gjatë fazes së realizimit të deponisë, të udhëheq me deponinë dhe të bëj kontrollin e punës gjatë eksplotimit të deponisë, të analizoj stabilitetin e deponisë nga parametrat gjeomekanik të fituar në terren si dhe të punoj projektin mbi sanimin e deponisë.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerate, Ushtrime dhe Elaboratë
Metodat e vlerësimit:	Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së sëcilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 10% Provimi final 55% Total 100%
Literatura primare:	[1] Dr.sc. Qani V. KADIRI, Ligjeratat e autorizuara nga Projektimi i deponive FNA, Prishtinë [2] Braja Das, Principle of Geotechnical Engineering, USA
Literatura shtesë:	[3] Timothy G. Townsend&tjerë: Sustainable Practices for Landfi II Design and Operation

Titulli i lëndës:	Hartografi
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda fillon me Hartografisë si shkencë dhe lidhjen e saj me shkencat tjera, më pas jepet historiku i shkurtër i hartografisë, vazhdon me bazën matematike të hartave me përqendrim në shkallën e zvogëlimit, sistemet e koordinatave, projeksionet hartografike, përshkrimin e proceseve të përpilimit të hartave, që më pas të vazhdojë me paraqitjen e elementeve gjeografike në hartë, modelimin e hartave, përgjithësimin hartografik, automatizimin bashkëkohor në hartografi, hartografinë tematike dhe hartometrinë. Lënda përfundon me mësim praktikë për përpilimin e hartave dhe prezantimin e punimeve individuale e seminarike të studentëve.
Qëllimet e lëndës:	Mes kësaj lënde u mundësohet studentëve të përfitojnë njohuri themelore teorike dhe praktike për hartografinë si disiplinë shkencore, edhe atë duke filluar që nga paraqitja e elementeve themelore të saj, ndarjes së saj në nëndisiplina shkencore, bazën matematike e gjeodezike të hartave, emërtimin e tyre, sistemet e koordinatave, njohuri themelore mbi globin dhe atlasin gjeografik, proceset për përpilimin e hartave, paraqitjen e elementeve gjeografike në hartë, modelimin e hartave, përgjithësimi hartografik, metodat bashkëkohore digjitale, ngarkesën e hartave, hartografinë tematike dhe hartometrinë. Njohja e elementeve matematike që përmbajnë hartat, e proceseve për përpilimin e hartave dhe mënyrat-standardet për paraqitjen e elementeve gjeografike do tu ndihmojnë studentëve të fitojnë njohuritë fillestare për shfrytëzimin dhe përpilimin e hartave.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>1. Studenti njih hartografinë si shkencë, historikun e hartografisë dhe prodhimet hartografike</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i hartografisë si shkencë. - Shpjegimi i historisë së hartografisë. - Lidhja e hartografisë me shkencat tjera. - Karakteristikat e prodhimeve hartografike. <p>2. Studenti njih proceset për përpilimin e hartave.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpjegimi i projektit mbi përpilimin e hartës. - Shpjegimi i fazave mbi përpilimin e hartës - Definimi i elementeve matematike të hartës. - Shpjegimi i mënyrave të kolektimit të të dhënave hapësinore. - Interpretimi i botimit, reproduksionit dhe azhurnimit të hartave. - Shpjegimi i përpilimi të hartave me shkallë të mesme e të vogël. <p>3. Studenti njih përmbajtjen e hartës</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpjegimi i elementeve matematike të hartës. - Shpjegimi i elementeve gjeografike të hartës. - Shpjegimi i elementeve redaktuese dhe ndihmëse të hartave. <p>4. Studenti njih metodologjinë-standardet e përpilimit të hartave.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohja e standardeve të modelimit të hartave. - Interpretimi i standardeve mbi paraqitjen e elementeve gjeografike në hartë. - Njohja me procesin e përgjithësimit hartografik - Aplikon metodat për përpilimin e hartave tematike. <p>5. Studenti njih trendet bashkëkohore në hartografi.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpjegimi i automatizimit në hartografi. - Shpjegimi i lidhjes ndërmjet GIS-it dhe hartografisë. - Shpjegimi i hartës digjitale ndërkombëtare/globale të Botës. <p>6. Studenti njih metodat për matje në harta.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i metodave për matjen e largësive nga harta. - Përdorimi i metodave për matjen e sipërfaqeve nga harta.

	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i metodave për llogaritjen e vëllimeve nga harta. - Ndërtimi i profilit të terrenit nga harta. - Përcaktimi i koordinatave dhe lartësive mbidetare nga harta.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Paraqitja e simbolizuar estetike dhe funksionale e të dhënave gjeohapësinore, në hartat elektronike bazuar në teknologjinë ueb, desktop dhe mobil. Lënda është bashkëkohore dhe bazike për nivelin baçellor.
Metodat e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligjëratat me prezantim dhe demonstrime praktike të hartave. - Ushtrimet numerike. - Seminar semestral me detyra konkrete. - Përpilim të hartës si punim individual semestral. - Ese semestral me temë të caktuar. - Diskutime gjatë ligjëratave. - Ushtrime në grupe.
Metodat e vlerësimit:	<p>Pjesëmarrja në ligjëratat: 10%</p> <p>Punimi seminarik: 10%</p> <p>Punimi individual: 10%</p> <p>Ese-i: 10%</p> <p>Kolokuiumi i parë: 30%</p> <p>Kolokuiumi i dytë: 30%</p> <p>Provimi final: 60%</p> <p>Total: 100%</p>
Literatura primare:	<p>Idrizi B.: Përpilimi i hartave dhe përgjithësimi hartografik, Shkup 2006.</p> <p>Idrizi B.: Hartografi, Shkup 2006.</p>
Literatura shtesë:	<p>Terry A.: Thematic cartography and geovisualization, Prentice, 3rd edition, 2008.</p> <p>www.icaci.org</p>

Titulli i lëndës:	Kontrollimi i ndotjes së ajrit
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Kjo lende ju mundëson studenteve përvetësimin e njohurive teorike dhe praktike për ndotësit e ajrit që vijnë nga proceset e emisioneve, trafiku rrugor, ajror dhe ndotësit e tjerë.
Qëllimet e lëndës:	Të kuptuarit e proceseve fiziko-kimike, meteorologjisë, klimatologjisë si dhe ndërveprimeve komplekse brenda sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit në shkallë vendi. Krijimi i bazës së të dhënave të monitoruara në rrjetin e monitorimit të cilësisë së ajrit nga procesi i emisionit. Kontrollimi i cilësisë së ajrit edhe në objektet e mbyllura si fabrika, shkolla, lokale, etj. Njoftimi me strategjitë dhe legjislacionin për problematiken e ndotjes së ajrit në shkallë vendi.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: 1. Te jete i pavarur në punën e tij për analizimin e të gjithë parametrave të monitoruar për cilësinë e ajrit sipas rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit në shkallë vendi. Disperzionin e ndotjes sipas rrymimeve ajrore dhe trëndafililit të erës në shkallë vendi. 2. Te fitojnë njohuri themelore në lidhje me aplikimin e metodave bashkëkohore në sistemin e monitorimit të cilësisë së ajrit përmes analizave fiziko kimike në laboratorë. 3. Te fitojnë njohuri për kalibrimin dhe mirëmbajtjen e aparaturës matëse dhe asaj analizuese në laboratorët që merren dhe janë të certifikuara për analizat fiziko-kimike të cilësisë së ajrit.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, punë praktike në grupe, seminare, konsultime, qasje interaktive, prezantime të studenteve etj.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30%. Vlerësimi i dytë; 25%. Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%. Vijimi i rregullt 5%. Provimi final 30%. Total 100%.
Literatura primare:	1. Kimia e mjedisit grup autoresh FSHMN Tirane 2010 2. MM dhe PU Monitorimi i cilësisë së ajrit urban Tirane 2007 3. Kimija e mjedisit Akademik N.Daci 2005
Literatura shtesë:	http://www.ammk-rks.net , https://mmpm.rks-gov.net

Titulli i lëndës:	Ligji mbi mbrojtjen e ambientit
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Kjo lende ju mundëson studenteve përvetësimin e njohurive bazike nga fusha e legjislacionit mjedisor, strategjitë mjedisore si dhe politikat integruese në relacion me standardet mjedisore evropiane.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet studimore të lëndës janë: Të ofrojë njohuri mbi ligjin mbi mjedisin, që merret me mbrojtjen e mjedisit. Materia studiuese: Lënda përfshin kapitujt si: Ligji mbi mjedisin: rëndësia. Burimet e ligjit për mjedisin. Marrëveshjet ndërkombëtare. Protokollet. Ligji i zakonshëm. Vendimet juridike. Parimet e organizmit. Disa raste me rëndësi të ligjit për mjedisin. Trajnimi i ekspertëve ligjor në fushën e ligjit mbi mjedisin. Grupet të ligjit mbi mjedisin. Kërkimet shkencore në fushën e ligjit për mjedisin.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentet nga ky kurs do të jenë në gjendje që t'i njohin të gjitha burimet juridike nacionale dhe më gjerë që e rregullojnë mbrojtjen e mjedisit. Veçanërisht do i njohin institute dhe parimet themelore mbi krijimin dhe funksionimin e një sistemi juridik në fushën mjedisore si në planin qendror ashtu edhe në atë lokal. Kursi është i veçantë në aspektin e shpjegimit të lidhjes në mes të legjislacionit vendor ambiental dhe të konventave, kontratave ndërkombëtare, protokolleve që në fazën përfundimtare u epin informata dhe detyra shtesë dhe permanente për të njohur detyrimet ndërkombëtare në fushën e ambientit. Njohuritë thellohen jo vetëm në aspektin e legjislacionit vendor por edhe të krahasueshmerisë së tyre ne ato të Unionit Evropian.
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, punë praktike në grupe, seminare, konsultime, qasje interaktive, prezantime të studenteve etj.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30%. Vlerësimi i dytë; 25%. Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%. Vijimi i rregullt 5%. Provimi final 30%. Total 100%.
Literatura primare:	1. Ekologjia i ekolosko pravo – Dr. B. Golic 2. MM dhe PU Monitorimi i cilësisë së ajrit urban Tirane 2007 http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,122 http://mmph.rks-gov.net/?cid=1,4 http://www.ammk-rks.net ,
Literatura shtesë:	

Titulli i lëndës:	Analiza e të dhënave të ambientit
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Përmbajtja e lëndës përfshin: Përvetësimi dhe përpunimi i informatës ambientale e fokusuar në disa fusha sic është ndotja e ajrit dhe e ujit, analiza e sedimenteve, mikrobiologjia, etj. Analiza dhe interpretimi i të dhënave ambientale në kohë reale dhe historike. Shfrytëzimi i kompjuterëve për analiza dhe shpalosje, vlerësim të ndryshueshmërisë hapësinore dhe të përkohshme. Principet bazë të statistikave dhe GIS. Shfrytëzimi i MS Excel sotverit me sofverë Statplus dhe SPSS. Metodat e analizës së të dhënave serike në kohë, përfshirë probabilitetin dhe statistikat, korrelacionin, mostrimin dhe koherencën.
Qëllimet e lëndës:	Lënda u ofron studentëve njohuri dhe eksperiencë praktike për të interpretuar të dhëna laboratorike dhe fushore. Qëllimi i lëndës është që të ofrojë studentë me njohuri bazë të metodave probabilistike dhe statistike për të analizuar disa fenomene, me theks në disa studime të të dhënave ambientale.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të lëndës, studentët do të: <ul style="list-style-type: none"> • paisen me njohuri të nevojshme për t'u marrë me analizë të të dhënave • mund të shfrytëzojnë teste statistikore të duhura • aplikojnë paketa statistikore ndaj bashkësisë së të dhënave • vlerësojnë projekte në bazë të të dhënave.
Metodat e mësimdhënies:	Lënda zhvillohet prej ligjëratave, ushtrimeve dhe prezentimeve
Metodat e vlerësimit:	Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Detyra tw shtwpisw 30% Kolokfium 30% Provimi final 40%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Environmental Monitoring and Characterization Janick Artiola, Ian L. Pepper, Mark L. Brusseau Elsevier Science & Technology Books,2004 2. Methods of environmental data analysis C.N. Hewitt, Springer ,1992
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Statistical procedures for analysis of environmental monitoring data & risk assesment, McBean E.A., Rovers, F.A., Printece Hall PTR, 1998

Titulli i lëndës:	Menaxhimi i mbeturinave të ngurta
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda: Menaxhimi i mbeturinave të ngurta trajton organizimin e qëndrueshëm dhe eficient të sistemit menaxhues të mbeturinave të ngurta duke përfshirë zhvillimin e teknologjive dhe teknikave të reja të menaxhimit modern si dhe implementimin e direktivave dhe standardet e EU. Gjithashtu lënda trajton edhe mënyrat e reciklimit/ripërdorimit si dhe deponimit të mbeturinave të ngurta.
Qëllimet e lëndës:	Përfitimi i njohurive të duhura rreth mënyres së analizës, planifikimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave të ngurta
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët do të pregaditen të bëjnë identifikimin e metodave dhe teknikave më të përshtashme për zvoglimin e sasive të mbeturinave dhe për ripërdorimin e tyre. Studentët do të pajisen me njohuri si bëhen vlerësimet dhe preventivat nga ndotja dhe do të udhëzohen si aplikohen ligjet, standardet dhe direktivat e EU për mbeturina të ngurta.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratë, ushtrime, vizita në teren dhe puna seminarike
Metodat e vlerësimit:	Mënyra e vlerësimit do të jetë si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 25% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 10% Provimi final 30% Total 100%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Menaxhimi I mbeturinave te ngurta .Amra Serdarevic. Universiteti I Sarajeves, Fakulteti i Nderimtarise, 2016 2. Mbetjet e ngurta dhe trajtimi I tyre . Elmaz Shehu, Tirane,2009 3. Handbook of Solid Waste Management by, Frank Kreith , George Tchobanoglous
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Municipal Solid Waste Management, by: Ludwig Christian, Hellweg Stefanie 2. Integrated Solid waste management A Life cycle inventory, by Forbes McDougall

Titulli i lëndës:	Teknologjitë e trajtimit të ujit të ndotur
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda vlerëson nevojën e kualitetit të ujit dhe mënyrën se si arrihet ky kualitet duke trajtuar ujin për pije dhe ujin e ndotur. Paraprakisht, lënda shtjellon konceptet bazë të trajtimit të ujit për pije dhe ujit të ndotur. Duke qenë ky një ballafaqim baze për studentët, fokusi do të shtrihet në përshkrimin e disa përmbajtësve ndotës dhe disa teknologjive trajtuese që shfrytëzohen sipas nevojës për trajtim të ujit për pije dhe ujit të ndotur.</p> <p>Temat që do të përfshihen janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vetitë bazë dhe karakteristikat e ujit - Ekuilibri i materialeve, reaksionet dhe reaktorët - Nevoja e zbatimit të standardeve për ujë të pijes dhe ujë të ndotur - Trajtimi i ujit për pije - Trajtimi i ujit të ndotur - Faktorët me rëndësi për dizajn të impianteve të trajtimit të ujërave
Qëllimet e lëndës:	Rritja e kërkesës për ambient të shëndetshëm në vend, imponon nevojën e ndërtimit të impianteve trajtuese të ujit për pije dhe ujit të ndotur. Prandaj, kjo lëndë synon në përgatitjen e studentëve për përshkrimin dhe njohtimin bazë të proceseve trajtuese të ujërave dhe për aplikimin e proceseve adekuate për trajtim të ujërave tipike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Me të përfunduar të lëndës, studentët do të jenë të aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategorizojnë cilësinë e ujit duke iu referuar standardeve të ujit, • përshkruajnë dhe përzgjedhin proceset bazë dhe adekuate trajtuese të ujit dhe • skematizojnë sistemet trajtuese të ujit.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Mbrojtja dhe ruajtja e resurseve ujore.
Metodat e mësimdhënies:	Lënda zhvillohet prej ligjëratave të ofruara në formë skripte, ushtrimeve numerike të zgjedhura në klasë dhe shtëpi, vizit-ës/-ave në teren të impiant-it/-eve ekzistuese të ujit për pije dhe ujit të ndotur.
Metodat e vlerësimit:	<p>Parakusht: Lënda – Menaxhimi i ujit urban</p> <p>Vlerësimi bëhet nga 0-100 %</p> <p>Vlerësimi i parë: 35%</p> <p>Vlerësimi i dytë 35%</p> <p>Detyrat e shtepise 30%</p> <p>Vijimi i rregullt – vendimtar në rastet kufitare</p> <p>Provimi final</p>
Literatura primare:	1. Ahmed, F. <i>Teknologjitë e Trajtimit të Ujërave, 2010</i>
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Crittenden, J., Montgomery, W. H. <i>Water Treatment Principles and Design</i>. 2nd ed, MWH, Canada, 2005. 2. Metcalf & Eddy, Inc. <i>Wastewater Engineering: Treatment and Reuse</i>. 4th ed, McGraw Hill, Inc., New York, 2003. 3. Qasim, S. R. <i>Wastewater Treatment Plants: Planning, Design and Operation</i>. 2nd ed, CRC, Texas, 1999.

Titulli i lëndës:	Mbrojtja dhe përforcimi i dherave
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lënda: Mbrojtja dhe përforcimi i dherave përfshinë: Njohuri mbi dherat e dobëta, Hulumtimet e dheut nga sipërfaqja e terrenit, Provat në terren “in situ”, metodat e përforcimit të dherave, përfocimi mekanik i dherave, përforcimi i thellë i dherave, përforcimi me çimento, me gëlqera, me hirin e TEC-eve, përforcimi kimik i dherave, përforcimi hidraulik i dherave, përforcimi me mbingarkim, njohuri mbi materialet gjeosintetike, përforcimi i dherave me material gjeosintetike, aplikimi i materialeve gjeosintetike në infrastructure rrugore.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kursit(modulit): Të njihen e parimet bazë mbi përforcimin e dherave të cilët më vonë do t'i përdorin për analizën e stabilitetit të murit mbrojtës, pjerrësirave dhe trupit të rrugës.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me përfundimin e ligjëratave të kësaj lënde studentët do të kenë kuptuar parimet fundamentale mbi përforcimin e dherave, njohuri mbi provat laboratorike dhe “In situ” të dherave, punëve hulumtuese, metodat e përforcimit të dherave, interaksionin e tokës dhe materialeve gjeosintetike, stabilitetin e mureve mbrojtëse dhe pjerrësirave të përforcuara me materiale gjeosintetike.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerate, Ushtrime dhe Elaboratë
Metodat e vlerësimit:	Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 10% Provimi final 55% Total 100%
Literatura primare:	[1] Dr.sc. Qani V. KADIRI, Ligjeratat e autorizuara nga Mbrojtja dhe përforcimi i dherave, FNA, Prishtinë [2] Braja Das, Principle of Geotechnical Engineering, USA
Literatura shitesë:	[3] Jie Han, Principles and Practice of Ground Improvement, John Wiley& Sons, Inc., Hoboken, New Jersey

Titulli i lëndës:	Vlerësimi i ndikimeve ambientale
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Kjo lende ju mundëson studenteve përvetësimin e njohurive teorike për vlerësimin e ndikimeve ambientale. Në këtë kontekst hyjnë: njohja me konceptet themelore të zbatimit të VNM dhe VSM, Kërkesat ligjore dhe institucionale për zbatimin e VNM dhe VSM, Instrumentet, format dhe proceset e zbatimit në VNM dhe VSM, Zbatimi i VNM dhe VSM në kuadër të sektorëve të ndryshëm zhvillimorë me qëllim të parandalimit të ndikimit në mjedisit, etj.
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve nga lëmia e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të njohet me konceptet themelore të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis-VNM dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor-VSM. Mënyrat e zbatimit të VNM dhe VSM për parandalimin e ndikimeve në mjedis. Instrumentet, format dhe proceset e zbatimit të VNM dhe VSM. Projektet, planet, programet dhe politikat që kërkojnë zbatimin e VNM dhe VSM. Roli i institucionale lokale dhe qendrore në zbatimin e VNM dhe VSM. Rolin e VNM dhe VSM në zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, punë praktike në grupe, seminare, konsultime, qasje interaktive, prezantime të studenteve etj.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30%. Vlerësimi i dytë: 25%. Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%. Vijimi i rregullt 5%. Provimi final 30%. Total 100%.
Literatura primare	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sallari.S (2013); Vlerësimi i Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës. 2. Terrivel. R (2010) Strategic Environmental Assessment in Action, Earth Scan, London-Washington DC. 3. Glasson J. et al (2012) Introduction to Environmental Impact Assessment, Fourth Edition, Routledge, New York. 4. Ramadani I. (2011) Mjedis jetësor, sfidat dhe perspektivar-rolin e njeriut. 5. Materiale dhe shënime të përgatitura nga profesori i lëndës.
Literatura shtesë:	http://www.ammk-rks.net , https://mmpm.rks.gov.net

Titulli i lëndës:	Energjia dhe ambienti
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Energjia – nga ku e marrim, si e shfrytëzojmë ne mënyrë eficiente dhe si te reduktojmë efektet negative nga prodhimi i saj, konvertimi, shpërndarja dhe shfrytëzimi. Kjo është sfida e me e madhe e kohës aktuale mjedisore dhe shoqërore qe bota përballet tani. Kjo lende do te ofroje njohuri mbi këto tema.
Qëllimet e lëndës:	Kjo lende është një mundësi per studentet qe te kontribuojnë drejtpërdrejtë ne menaxhimin e energjisë ne komunitetet lokale. Kjo lende do te ketë casje përmes zhvillimit te projekteve duke ofruar studentet se bashku per te studiuar dhe qe ata te zhvillojnë te kuptuarit e sistemeve te energjisë përmes projektit te tyre. Keto projekte do te fokusohen ne menaxhimin e energjisë, eficientë dhe reduktimit te gazrave serre.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Të fitoj njohuri mbi problemet themelore elementare në fushën e burimeve të energjisë dhe ambientit dhe të ofroj propozime për zgjidhjen e këtyre problemeve; të jetë në gjendje të kuptojë, aplikojë dhe diskutoj konceptet dhe parimet themelore të ndërlidhjes së energjisë me ambientit për nevojat e fushës së inxhinierisë së ndërtimit dhe ambientit.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratë dhe punim seminari në grupe
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja: 10 % Vlerësimi i parë: 20% Vlerësimi i dytë: 20 % Projekti 50% Total 100%
Literatura primare:	[1] Prof. Ass. Dr. Mimoza Dugolli Leksione: Energjia dhe Ambienti, FNA, Prishtinë
Literatura shtesë:	[2] Roger A. Hinrichs and Merlin Kleinbach. "Energy: Its Use and the Environment", Fifth edition, Thompsoh Learning, 2013. [3] Michale Allaby, "Basics of Environmental Science", Taylor and Francis Group. [4] Gopal Nath Tiwari and Rajeev Kumar Mishra, "Advanced Renewable Energy Sources"

Titulli i lëndës:	Menaxhimi i projekteve
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Menaxhimi i projektit sot është një vegël e domosdoshme për një projekt të sukseshëm. Aktualisht por edhe në të ardhmen konsiderohet se në Menaxhimin e projektit do të përfshihen më shumë njerëz nga të gjitha llojet e fushave e aktivitetve punuese . Studentët do të marrin njohurit e mjaftueshme që nevojiten për të menaxhuar një projekt ose për të qenë pjesë e një projekti, duke i bërë ata (studentët) një aset të rëndësishëm për çdo sektor. Ky kurs ofron njohurit themelore për procesin e menaxhimit të projektit, menaxhimin e burimeve (koha , finacat dhe resurset njerzore), kontrollin e cilësisë, të komunikimit, dhe menaxhimin e riskut.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim të ofrojë studentëve mundësi për të aplikuar parimet e menaxhimit të projekteve në praktikë dhe t'i mundësojë një menaxheri të ardhshëm që me sukses të kompletoj projekte të avacuara duke respektuar limitet e kohës, kostos dhe burimeve tjera me rëndësi për një projekt.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me të përfunduar të lëndës, studentët do të jenë të aftë të: <ul style="list-style-type: none"> • Aftësi për të përcaktuar se çfarë është një projekt dhe të shpjegojë konceptet themelore të menaxhimit të projektit • Pricipet kryesore të organizimit dhe menaxhimit të një projekti në të gjitha fazat • Përdorim i pakos softwarike të aplikimit për Menaxhimin e një projekti
Metodat e mësimdhënies:	Lënda zhvillohet përmes ligjëratave të rregullta punimeve seminarike
Metodat e vlerësimit:	Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 35% Vlerësimi i dytë 35% Punimet individuale 30% Vijimi i rregullt – vendimtar në rastet kufitare Provimi final
Literatura primare:	1. Menaxhimi I Projektit, Prof.Dr Suzana Panariti,Tirane 2009
Literatura shtesë:	1. Menaxhimi I Projekteve, Prof.Dr Shyqyri Kelmendi,Prishtine 2011 2. A guide to the project management body of knowledge (PMBOK® guide).-Fifth edition. 2013

Titulli i lëndës:	Mbrojtja nga vërshimet
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Lenda Mbrojtja nga vërshimet përfshin: Hyrje në menaxhimin e integruar të vërshimeve, problemet që do të trajtohen, zgjedhjet që mund të merren. Hidrologjia dhe morfologjia e pellgut të lumit. Krijimi i lumenjeve dhe proceset në të. Proceset fluviale. Konceptet e rrezikut nga vërshimet. Principet e menaxhimit dhe objektivat e mbrojtjes së integruar nga vërshimet. Vlerësimi i dëmeve nga përmblytjet. Cenueshmeria. Indeksi i cenueshmerisë së vërshimeve. Masat mbrojtëse nga vërshimet. Principet projektuese të sistemeve teknike për mbrojtje nga vërshimet si muret dhe arginaturat, bazenet retnuese, etj. Mbrojtja nga vërshimet në zonat urbane. Sistemet e drenazimit të qendrueshëm. Vlerësimi i dëmeve nga vërshimet si dhe efikasiteti dhe aspekti ekonomik i masave mbrojtëse.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kursit (modulit): Kuptimi dhe aplikimi i metodave dhe koncepteve të menaxhimit të integruar të vërshimeve. Poashtu, mesimi mbi vlerësimin e sipërfaqeve të rrezikuara nga vërshimet, metodat dhe strukturat mbrojtëse që mund të ndermirren me qëllim të parandalimit dhe lehtësimit të vërshimeve që paraqiten në lokacione të ndryshme. Përcaktimi i prurjes projektuese për mbrojtje nga vërshimet.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: <ol style="list-style-type: none"> 5. Te definoj llojin e vërshimeve dhe karakteristikat e tyre, 6. Te identifikoj faktorët që shkaktojnë vërshimet dhe masat lehtësuese që mund të ndermirren për minimizimin e tyre, 7. Te kalkulojë prurjen projektuese për objektet për mbrojtjen nga vërshimet, 8. Te bëjë vlerësimin e paraqitjes së rrezikut nga vërshimet për një sipërfaqe të caktuar, duke u bazuar në të dhënat me të cilat disponohet. 9. Të aplikoj masat strukturore dhe jostrukturore për menaxhimin e integruar të vërshimeve.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	
Metodat e mësimdhënies:	Ligjeratë frontale, ex cathedra, diskutime të problemeve dhe analize të rasteve studimore, ushtrime numerike, punë seminarike në grupe dhe vizite në terren.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 40% Vlerësimi i dytë: 40% Punimi seminarik, angazhime tjera: 20%
Literatura primare:	1. Kusari, L., Lecture notes
Literatura shtesë:	2. Jansen, P.Ph. et al., Principles of river engineering - The non tidal alluvial river

Titulli i lëndës:	Sistemet fushore të trajtimit të ujërave të ndotura
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Nisur nga fakti se kanalizimet e kompletuara janë të pa mundshme për shumë banorë, sistemet e decentralizuara – fushore janë me interes për menaxhim të ardhshëm të ambientit. Lënda shtjellon këto tema : Përmbajtësit në ujëra të ndotura, burimet e ujërave të ndotura dhe rrjedhjet mesatare; Proceset paratrajtuese të ujërave të ndotura; Sistemet alternative të mbledhjes së ujërave të ndotura; Trajtimi biologjik; Filtrat e pakeluar një-kalimësh dhe shumë-kalimësh; Shkarkimi i efluentit tek sistemet fushore; Menaxhimi i biomaterieve të ngurta dhe ndotjeve (septage); Menaxhimi i sistemeve fushore të ujërave të ndotura.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim të prezantojë rëndësine e sistemeve fushore për vendbanime ku kanalizimi komplet mund të mos jetë i mundshëm apo i kënaqshëm; të demonstrojë tipet e sistemeve fushore; të ofrojë konceptet e menaxhimit të sistemeve fushore.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me të përfunduar të lëndës, studentët do të jenë të aftë të: <ul style="list-style-type: none"> • arsyetojnë nevojën e shfrytëzimit të sistemeve fushore të trajtimit të ujërave të ndotura • dallojnë tipet e sistemeve fushore dhe • prezantojnë dhe zgjedhin hapat menaxhues të sistemeve fushore
Rëndësia dhe aktualiteti i lëndës	Lirimi i impianteve të centralizuara të trajtimit të ujërave dhe favorizimi i sistemeve gjithnjë e më i madh për shkak të rishfrytëzimit të ujërave shumë afër vendit të gjenerimit të tyre, përshtatshmërisë për klaster shtëpishë e objekte të vecanta.
Metodologjia e mësimdhënies:	Lënda zhvillohet përmes ligjëratave të rregullta dhe ushtrimeve numerike të zgjedhura në klasë (në grup prej 2-3 studentëve) dhe individualisht në shtëpi.
Metodat e vlerësimit:	Parakusht - Lënda: Menaxhimi i ujit urban Vlerësimi bëhet nga 0-100 % Vlerësimi i parë: 35% Vlerësimi i dytë 35% Detyrat e shtëpise 30% Vijimi i rregullt – vendimtar në rastet kufitare Provimi final
Literatura primare:	1. Ahmedi, F. Shenime të ofruara për ligjëratat
Literatura shtesë:	1. Crites, R., Tchobanoglous, G. Small and Decentralized Wastewater Management Systems, McGraw-Hill, 1998 2. US EPA. Onsite Wastewater Treatment Systems Manual, 2002 3. Metcalf & Eddy, Inc. Wastewater Engineering: Treatment and Reuse. 4th ed, McGraw Hill, Inc., New York, 2003

Titulli i lëndës:	Ndikimi i planifikimit urban ne ambient
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Planifikimi Urban dhe Ambientet e Qëndrueshme ofrojn një pasqyrë të praktikës bashkëkohore lidhur me hartimin dhe planifikimin e mjedisit të ndërtuar për zhvillim të qëndrueshëm. Konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm urban. Zhvillimi fizik i qyteteve i ndikuar nga gama komplekse dhe e ndërvarur e faktorëve sociale, ekologjike, ekonomike, dhe politike. Mënyrat e veçanta në shprehjen hapësinor të karakteristikave të urbanizimit dhe implikimet për të dy qasjet, si e vetme dhe si shumë-dimensionale në zhvillimin e qëndrueshëm. Çështjet, konceptet dhe qasjet studimore të lidhen ngushtë me ato të mbuluara në Politikat Urbane, Kulturore dhe Sociale.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit: Për të shqyrtuar konceptet e qëndrueshmërisë dhe mjetet e planifikimit urban që të përdornim për të arritur zhvillimi i qëndrueshëm urban; Për të siguruar një kuptim të marrëdhënieve midis sektorëve të ndryshëm urbanë, si infrastruktura me sistemet tjera të mjedisit të ndërtuar dhe sistemeve ekologjike. Për të vlerësuar rolin e planifikuesit urban që ka në promovimin e çështjeve shoqërore, ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm për mjedisin, dhe për të rritur të dëgjuarit, vëzhgimin, të menduarit kritik, komunikimin, dhe bashkëpunimin.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me të përfunduar të lëndës, studentët do të jenë të aftë të kuptojnë idenë e zhvillimit të qytetit bazuar në faktorët natyror, politikat urbane, kulturore dhe shoqërore.
Metodat e mësimdhënies:	Lënda zhvillohet përmes ligjëratave të rregullta dhe ushtrimeve numerike të zgjedhura në klasë dhe shtëpi.
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: • Vlerësimi i parë: 35% • Vlerësimi i dytë 35% • Detyrat e shtepise 30% • Vijimi i rregullt – vendimtar ne rastet kufitare • Provimi final
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> • Dieter Prinz :Urbanizmi -Planifikimi Hapesinor ,Prishtine, 2012 • Urban Design Associates: The Urban Design Handbook, Techniques and Working Methods, W.W. Noton & Company, 2003
Literatura shitesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Antonia Layard, Simin Davoudi and Susan Batty: Planning for a sustainable future, SPON Press, First Edition, 2001 • Patsy Healey, Abdul Khakee, Alain Motte, Barrie Needham: Making Strategic Spatial Plans-Inovation in Europe, Taylor &Francis, 2006

Titulli i lëndës:	GIS në ambient
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Aplikimi i Sistemit Gjeografik te Sistemit ne studimin e mjedisit natyror, si: definimi i GIS, komponentët e GIS, natyra dhe burimi i të dhënave gjeografike, përpunimi automatik i të dhënave gjeografike, digjitalizimi i hartave, projeksionet hartografike, krijimi i gjeo-databazave, veçorive, etj.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është për të futur nxënësit të më efektive metodat e kompjuterit të bazuar për ndërtimin harta gjeo-shkencore. Theksi do të jetë në krijimin e hartave dixhitale GIS nga e para duke përdorur të dhënat e perfituara nga terreni, në vend te atyre te perfituara nga dixhitalizimi nga harta. Kursi kryesisht përdor softuer komercial dhe jo komercial te GIS-it.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që të: <ol style="list-style-type: none"> 1. Digjitalizojë harta të ndryshme duke i vendosur te dhënat paraprakisht 2. Te përdorë gjeoinformacionet ne mjedis 3. Te ketë njohuri ne aplikimin e GIS-it ne fusha te ndryshme 4. Te hartojte projekte te ndryshme profesionale ne mënyrë te pavarur
Metodat e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligjëratë - Diskutime gjatë ligjëratave. - Ushtrime - Punë në grupe.
Metodat e vlerësimit:	Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 10% Vlerësimi i dytë 10% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 5% Vijimi i rregullt 20% Provimi final 55% Total 100%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1) Ian H.: An Introduction to Geographical Information Systems, Fourth Edition, 2012 2) Robert S.: GIS for environmental management, 2006
Literatura shtesë:	An Introduction to the Theory of Spatial Object for GIS, Taylor & Francis Ltd, London, Molenaar, M (1998)

Titulli i lëndës:	Materialet polimere dhe aplikimi në inxhinierinë e ambientit
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Njohurite baze për Materialet Polimere. Procesi i prodhimit të materialeve polimere. Sfidat dhe zëvendësimi i materialeve konvencionale me materialet polimere. Sjellja e materialeve polimere nën veprimin e ngarkesave. Aplikimi i materialeve Polimere në fushën e ndërtimit. FRP dhe aplikimet praktike në performancë. Përdorimi i fibrave si forcim dhe mikroarmim. Dysheqmet industriale. Reciklimi i materialeve Polimere.
Qëllimet e lëndës:	Te aftësojë studentet në njohuritë për materialet Polimere; vetitë e tyre dhe eksaminimet e vetive me qëllim të përdorimit në fushën e Inxhinierisë së ambientit në pozicione të ndryshme
Rezultatet e pritshme të nxënies:	-te njohë materialet polimere që janë përdorur me kohën -te përcaktojë karakteristikat fizike, mekanike, kimike dhe fiziko-mekanike të materialeve -te përdorë materialet adekuate për pozicionet dhe objektet përkatëse -bazuar në të arriturat dhe zhvillimin teknologjik të mund të bëjë ndonjë avansim eventual
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	<ul style="list-style-type: none"> - Nderlidhja e lëndës me zhvillimin dhe aplikimin në teknologjitë e reja - Rritja e jetëgjatësisë së materialeve me baze polimere - Aktualizimi i procesit të Reciklimit dhe ripërdorimit
Metodat e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligjëratat me prezantim dhe demonstrime praktike të materialeve të ndërtimit - Praktike profesionale - Seminar semestral me detyra konkrete. - Diskutime gjatë ligjëratave. - Ushtrime në grupe.
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> - me shkrim 50% - Me gojë 50% - Pjesa me gojë ngrerthen edhe prezentimet
Literatura primare:	1/N.Kabashi- Materialet Polimere dhe Aplikimi në Inxhinierinë e Ambientit (ligjerata) 2/Prof asoc. Fisnik Kadiu: Teknologjia e Materialeve të Ndërtimit
Literatura shtesë:	1/Mustafa Akay: Introduction to Polymer Science and Technology 2/Robert O.Ebewele: Polymer Science and Technology 4/Zelimir Simunic: Polimer u Graditeljstvo 5/ Dr.Miltiadis A.Boboulos: Manufacturing Processes and Materials: Exercises

Titulli i lëndës:	Hidrogjeologjia
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Hidrogjeologjia është një degë e shkencave të tokës që merren me lëvizjen dhe ruajtjen e ujit në koren e Tokës dhe trupave të tjerë shkëmborë në tokë andaj edhe kursi do të trajtoj rrjedhjen e ujit dhe fenomenet që shaktohen nga rrjedhja që ndodhin në koren e tokës dhe trupat shkëmbor. Kursi do të trajtoj nga fillimi ciklit ujqor deri te akuiferet, pricipet e rrjedhjeve nëntoksore dhe rrjedhjet në puse shkallën e infiltrimit dhe rimbushjes . Gjithashtu do të trajtohen edhe pjesa e kimise se ujrave dhe gjurmimit te ujrave në mjedis
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të proceseve hidrogjeologjik ne natyre . Ne gjithashtu do të shqyrtojë analizat themelore teorike dhe metodat e përdorura në terren hidrogjeologjisë
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me përfundimin e kësaj lënde studentët duhet të jenë në gjendje të: 1. Kuptimi i faktorëve fizikë kontrollin transportin e ujërave nëntokësore në media poroze 3. Ndikimin ne mjedis levizjes se ujit dhe opcionet per shfrytezim 2. Njohuri bazike për zgjidhjen e problemeve praktike në fushen e mbrojtjes dhe shfrytezimit e ujrave nëntoksore
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratë, ushtrime, vizita në teren dhe puna seminarike
Metodat e vlerësimit:	Mënyra e vlerësimit do të jetë si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 25% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 10% Provimi final 30% Total 100%
Literatura primare:	[1] Hidrogjeologjia II, H.Dakoli ,Tiranë, 1997 [2]. Applied Hydrogeology, C.W. Fetter, 4th Edition, Prentice Hall, 2001
Literatura shtesë:	[1] Chemical and Isotopic Groundwater hydrology, Emanuel Mazar,2004

Titulli i lëndës:	CAD
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	CAD (Computer Aided Drafting) është program fleksibil për projektim dhe dizajnim, e aplikuar në fusha të ndryshme teknike. Projektimi në fushat inxhinierike është lehtësuar dukshëm me aplikimin e programeve CAD, duke mundësuar precizitet më të madh në punë; modifikim më të lehtë të projekteve; dhe efikasitet, sidomos në projektet në të cilat duhet bërë përsëritje të planeve /vizatimeve. Me ndihmën e kësaj lende arrihet të krijohen projekte / vizatime të prezentueshme, të përdorueshme, si të tilla të mund të printohen, dhe lehtë të shkëmbehen me profesionist të tjerë.
Qëllimet e lëndës:	Njoftimi me njohuritë nga fusha e CAD-se edhe avansimi në përdorimin e programit AutoCAD.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje t'i kuptojë principet themelore të CAD sistemeve edhe të punon vizatime vektoriale dydimensionale apo modele tri-dimensionale bazike në programin AutoCAD.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjeratë + Ushtrime (në AutoCAD ver. 2013)
Metodat e vlerësimit:	Kollokiumi i parë: 20% Kollokiumi i dytë: 25% Provimi final 55% Total 100%
Literatura bazë:	Berisha, R. (2011), AutoCAD 2010, Prishtinë
Literatura shtesë:	Byrnes, D., (2011), AutoCAD2012 , John Wiley&Sons, Inc. Gindis, E., (2012), Up and Running with AutoCAD, Elsevier Inc. dhe e gjithë literatura nga kjo lëmi.

Titulli i lëndës:	Ekologjia e përgjithshme
Arsyeshmeria dhe përshkrimi i lëndës:	Ky kurs përfshinë studimin mbi popullsinë, ekologjinë e komuniteteve dhe nivelin e ekosistemeve bimore dhe shtazore. Kursi do të fokusohet në ndërveprimet e organizmave me njëri-tjetrin dhe me mjedisin e tyre abiotik. Një kujdes të veçantë do ti kushtohet edhe mardhënies së të ushyerit të organizmat e gjallë duke përfshirë nivelet e ndryshme ushqyese. Gjithashtu kursi përmban edhe leksione për ciklin e qarkullimit të azotit, fosforit, karbonit, oksigjenit, ujit, etj. në mjedis. Klasifikimi i ekosistemeve dhe biodiversiteti do të jenë një fokus tjetër i kursit. Ekosfera dhe përbërës të sajë. Marrëdhëniet midis shkencës bazë ekologjike dhe problemeve aktuale mjedisore. Ngrohja globale dhe ndikimi i sajë në organizmat e gjallë. Ndotja, ndotësit dhe efektet e tyre në mjedis. Ndotja e ajrit: burimi, niveli i ndotësve në atmosferë dhe problemet shëndetësore. Ndotja e tokës dhe ujit
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka si qëllim që studentëve t'u ofrojë njohjen bazike të koncepteve ekologjike dhe rëndësinë e secilit përbërës mjedisor biotik apo abiotik. Qëllim tjetër është që studentët të nxisë për studiuar më shumë për problematikat e mjedisit jetësor por edhe për të qenë më të kujdesëshem për atë.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> • Të njoh konceptet themelore të popullatës, komunitetit dhe ekologjisë në nivel të ekosistemeve. • Të jenë në gjendje të flasin dhe të shkruajnë në mënyrë të qartë dhe koncize për konceptet kryesore në ekologji. • Njohja e ndërlidhjeve midis koncepteve kryesore të ekologjisë. • Të jetë në gjendje të hartojë një studim ekologjik që adreson pyetjet relevante, të kryejë studimin duke përdorur pajisjet përkatëse dhe të interpretojë dhe të paraqesë studimin tuaj tek bashkëmoshatarët tuaj. • Të hulumtojnë se si konceptet ekologjike që mësoni në klasë lidhen me problemet aktuale të mjedisit. • Të aplikojnë konceptet bazë të ekologjisë në praktikë.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike në laborator, konsultime, projekte të pavarura, kuize, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.
Metodat e vlerësimit:	1. Mundësia e vlerësimit gjatë leksioneve: Vlerësimi i parë (kolokvium, pyetje të mbyllura): 30% Vlerësimi i dytë (kolokvium, pyetje gjysmë të hapura): 30% Vlerësimi përfundimtarë (pyetje të hapura): 30% Seminaret ose angazhime tjera: 10% Total: 100% 2. Apo pas përfundimit të leksioneve (në afatet e provimeve): Vlerësimi me test me një rënë nga tri format e sipërpërmendura apo provim me gojë.
Literatura primare:	1. Ekologjia: Niko Peja and Laura Qorlaze (red.) Botuar, Tiranë: SHBLU, 1999. 2. Mjedijsi jetësor dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Libri Shkollor, Prishtinë, 2017.
Literatura shtesë:	• Ecology: Concepts and applications. Manuel C. Molles Jr. University of New Mexico, 2005.